

Zgjedhjet
rrezikojnë
fillimin e
negociatave
me BE

Fq.4



KANCERI
I GJIRIT
Rritet numri i
të prekurve, për
1 vit mbi 700 raste

Fq.4



Rikthimi
i trishtë
i Naserit

Sport

Fq.19



Koha

www.koha.mk

Përplasja e
madhe

Fq.14

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3477 · e premte, 5 tetor 2018

8°C | 23°C

15 DEN

AKTUALE

Të moshuarit
"viktimë" e
mashtresve



Të moshuarit shpesh herë bien pre e mashtresve të ndryshme në qytetin e Gostivarit. Zakonisht këta raste janë regjistruar viteve të kaluara por dukshëm janë prezente edhe këtë vit. Mashttrimet ndaj pleqve kryhen zakonisht në ditë tregu ose ditën kur merren pensionet, thonë burime policore, kur edhe kjo kategori e qytetarëve frekuenton pjesët qendrore të qytetit... Fq.9

RAJON

Vizat mund
të mos hiqen
deri në fund
të 2019-ës

Fq.14

GLOBI

Luftë
spiunësh,
Britania i
akuzon Rusinë
për sulme
kibernetike

Fq.15



BETEJA POLITIKE SHUMË SHPEJTË NË PARLAMENT

TRE SKENARËT PËR DALJE NGA KRIZA



Nga 71 deputetë që aktualisht mbështesin ndryshimet kushtetuese, pushteti shpreson edhe në gjashtë deputetët e pakicave brenda VMRO-së për të çuar numrin në 77 deputetë. Por nga VMRO duhet siguruar edhe katër deputetë tjerë që të sigurohet shumica prej 2/3, aq sa duhen sipas rregullores së Parlamentit për të votuar ndryshimet kushtetuese

Fq.3

Maqedonia dhe Shqipëria, më të varfrat

Shkup, 4 tetor - Qytetarët në Maqedoni konsumojnë bukë dy herë më të lirë se mesatarja evropiane dhe tre herë më të lirë se mesatarja në Zvicër, si shtet me çmimet më të larta në kontinentin e vjetër. Të dhënat e Entit të Statistikës së Maqedonisë tregojnë se niveli i çmimeve të frutave e perimeve në Zvicër është 3.6 herë më i lartë se në Maqedoni, ndërkohë që në vendin tonë çmimet e veshmbathjeve janë në

nivelin 49 për qind të çmimeve të Islandës, që shquhet me çmimet më të larta në Evropë për veshmbathje. Edhe cigaret në tregun tonë janë në nivelin prej 26 për qind të mesatares evropiane, apo janë tetë herë më të lira se në Norvegji. Ekonomistët thonë se përkundër çmimeve kaq të ulëta të më shumë artikujve në Maqedoni, megjithatë duke marrë parasysh harxhimet reale të jetesës...

Fq.5



EDITORIAL

A ËSHTË I MUNDUR PAJTIMI?



Emin AZEMI

Pajtimi politik brendamaqedonas që do të reflektohej në klimën e përgjithshme, nuk do të mund të bëhej pa lëshime të dhimbshme nga të dyja palët. Por është në dorën e kryeministrit Zaev që të inicojë këtë pajtim, me të gjitha elementet legale e legjitime të kompromisit, ku nuk do të përfshiheshin të inkriminuarit e ngjarjeve të përgjakshme të 27 prillit

Maqedonia ka nevojë për pajtim e jo për zgjedhje të parakohshme. Pajtimi duhet të jetë parimor e përmbytësor, kurse produkt i këtij pajtimi duhet të jetë krijimi i parakushteve për një klimë konstruktive politike, me protagonist bashkëpunues që do ta bënin vendin gati për integritet euro-atlantike.

Thelbi i çdo pajtimi është ndërprerja e armiqësisë pararendëse. Në politikë kjo është vështirë të arrihet, por vendimet e mëdha historike, sikundër dihet, janë bërë pikërisht mbi këtë parim, kurse kompromisi ka qenë vegla më e përshtatshme që e ka bërë të funksionojë një shoqëri a një shtet.

Maqedonia është përplot me armiqësi. Në njërin anë armiqësitë po e pengojnë komunikimin normal në mes të LSDM-së dhe VMRO-së, kurse në anën tjetër jo pak animozitete ka edhe në kampusin politik shqiptar.

Në kushtet e krijuara pas referendimit, po shkurtohet distanca kohore kur duhet të merren vendime të mëdha. Tani për tani janë në lojë të gjitha opsionet, përfshi pazaret për sigurimin e numrave të mjaftueshëm në Parlament, por edhe zgjedhjet e parakohshme. Njohësit e rrethanave juridike kanë shprehur skepticizmin e tyre se zgjedhjet e parakohshme janë përgjigja më e duhur ndaj krizës aktuale. Për një sërë segmentesh që ndërliken me reformën në drejtësi si dhe me rekomandime të shumta të Pribes, mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme konsiderohen si frenues të kursit reformues që duhet ta mbaj vendi deri në qershorin e ardhshëm kur pritet fillimi i negociatave me BE-në.

Një pengesë tjetër që paraqitet në dëm të idesë së mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme është edhe mosdefinimi i numri të përgjithshëm të popullsisë, që për rrjedhojë ka edhe defektet e shumta në përpilimin e regjistrit qendror të zgjedhjeve. Askush nuk do të donte të reprizohej ajo që ndodhi më 30 shtator, kur referendumi pësoi deformim edhe për shkak të listave me votues që ose kishin vdekur, ose ishin tretur në diasporë, ose nuk figuronin fare.

Pajtimi politik brendamaqedonas që do të reflektohej në klimën e përgjithshme, nuk do të mund të bëhej pa lëshime të dhimbshme nga të dyja palët. Por është në dorën e kryeministrit Zaev që të inicojë këtë pajtim, me të gjitha elementet legale e legjitime të kompromisit, ku nuk do të përfshiheshin të inkriminuarit e ngjarjeve të përgjakshme të 27 prillit. Në të kundërtën, kriza do të thellohet, kurse faktorët destabilizues do të imponojnë skemat e tyre të zgjidhjes së problemeve, që në fakt nuk janë kurrfarë zgjidhje por vetëm një prapaktheu në pozitë e palakmueshme të status-quo, larg NATO-s e BE-së dhe larg perspektivës ekonomike e sociale.

NJË PLATFORMË E GJENOCIDIT KOMUNIST MBI QYTETARËT SHQIPTAR

"Pak muaj më parë është zbuluar një Platformë e gjenocidit komunist mbi qytetarët shqiptarë, tre vite para se të ndodhte falimenti i dikaturës komuniste (1987). Platforma shtjellohet në letrën e ish ministrit të Punëve të Brendshme, Hekuran Isait, dërguar Sigurimit të Shtetit dhe Degëve të Punëve të Brendshme nëpër rrethe. Aty jepen udhëzime për hartimin e dy listave krahinë me krahinë, me qëllim, që në rastin më të parë të agresionit të huaj, këta qytetarë - kundërshtarë apo të pakënaqur nga rrëgjimi, të eliminoreshin. Ky dokument që e zotërojmë në rrugë jozyrtare, është publikuar nga gazeta "Minerva" e Nebil Çikës. Mandej është kërkuar zyrtarisht origjinali në rrugë institucionale nga Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit (ISKK) pranë Autoritetit për Informim të Dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), prej nga kemi marrë përgjigje se ky dokument nuk gjendet në arkiva. Është zhdukur? Ka shumë gjasa. Kush ndihmon për gjetjen në arkiva të këtij dokumenti unikal, jep një kontribut të çmuar qytetar e patriotik, në njohjen e shoqërisë me krimet monstruoze të komunizmit", ka shkruar një status në Facebook, shkrimtari Agron Tufa.

LETËRSIA NUK BËHET ME DIREKTIVA

"Në gjykimin tim prej njeriu që shkruan, letërsia nuk bëhet me direktiva. As me fushata, në veçanti ato kombëtariste. E provoi këtë sistemi i shkruar kur i dërgoi shkrimtarët pranë punëtorëve, të ashtuquajturës jetës së vërtetë, dhe dështoi. Rezultati që i mjerueshëm. Letërsi e stisur. U thureshin poezi makinerive; frigoriferëve dhe televizorëve.

Unë shkruaj atëherë kur më vjen diçka në grykë për ta thënë. Dhe as nuk e di se kur ajo do të më vijë. Jam në terr. Asnjë shkrimtar nuk e di se kur do t'i vijë një vepër e mirë. Ai që thotë e di, gënjen. Asnjë shkrimtar nuk mund ta zgjedhë temën për të cilën shkruan. Ajo të vjen nga lart. Është ajo që të zgjedh ty. Ti nuk mund të bësh asgjë veçse t'i bindesh, të ulesh e ta shkruash kur ajo të urdhëron ta nxjerrësh prej grykës", ka shkruar një status në Facebook, shkrimtarja nga Tirana, Arlinda Guma.

KOSOVA DUHET TA VËSHTIRËSOJË INTEGRIMIN E SERBISË NË BE

"Daçiqi në RTV paska kallxue qartë se ku i dhemb dhëmbi Serbisë: nëse ngrihet konflikti me Kosovën, atëherë ngrihet-bllokohet edhe integrimi i Serbisë në BE. Kjo i bjen që Serbisë i ngutet të gjendet një zgjidhje për Kosovën, që Serbia të integrohet në BE. Por, Kosova nuk ka pse ia lehtëson Serbisë rrugën e integritit në BE. Vetë Kosova në rrugën e integritit nuk është kurrkund. Prandaj, politika shtetërore e Kosovës duhet të jetë që t'ia vështirësojë Serbisë rrugën e integritit, duke e denoncuar për ndërhyrje e pretendime aneksioniste, e jo t'ia lehtësojë. Kosovës i konvenon t'ia vështirësojë Serbisë rrugën drejt BE-së, sepse vetëm në atë mënyrë minimizohen pretendimet serbe në drejtim të Kosovës", ka shkruar një status në Facebook, pedagogu dhe shkrimtari Milazim Krasniqi.

MEDIA Citate

PERËNDIMI SERBISË: PO U NISE NË KOSOVË, DO TË KESH LUFTË

Zbulohet pse sot Serbia ka hequr shkallën më të lartë luftarake të ushtrisë së saj në kufi me Kosovën. Arsyja është se kreu ushtarak serb kishte marrë një kërcënim të hapët nga Aleanca ushtarake Perëndimore. Nëse Serbia për çfarëdo arsyeje merr vendimin që me forcat e veta të ndërhyjë në Kosovë, do të hyjë në luftë të hapët, jo me forcat policore të Kosovës por me njësitë e KFOR-it e të NATO-s, ka qenë kërcënim i këto ditshëm nga NATO. Këtë kërcënim të drejtpërdrejtë e të rreptë lidhur me tensionet e fundit në Kosovë, e ka thënë në bisedë me zyrtarët serbë përfaqësuesi i lartë i njërit nga vendet më me ndikim të NATO-s në Beograd, përcjell portali serb "Novosti". "Ky diplomat ka qenë shumë i interesuar të dijë se si i sheh Beogradi ngjarjet në Liqenin e Ujmanit", citon kjo gazetë Beogradit të ketë thënë një bashkëbisedues i saj të cilin ajo nuk e identifikoi. Në po atë takim është shfaqur pakënaqësi e hapët e lidhur me ngritjen e shkallës së gatishmërisë së luftës të forcave të armatosura të Serbisë. Përfaqësuesi i këtij shteti s'është mburoi mundësinë konfliktit por ai tha se detyrë e KFOR-it është që forcat serbe t'i mbajë larg Kosovës Sipas kësaj gazete, ky nuk është kërcënim i parë që nga Perëndimi i bëhet Serbisë. "Çdo paralajmërim i Serbisë se do ta mbrojë popullin v e të në Kosovë, përcillet me pakënaqësi të vendeve perëndimore dhe me vërejtjen për Beogradin se do të ketë punë me NATO-n sikur në vitin 1999". Gazeta thekson se Serbia në planin e sigurisë nuk ka probleme me Kosovën, madje edhe nëse asaj i bashkohen forcat ushtarake të Shqipërisë, porse Kosova është nën ombrellën e NATO-s. Këto ditë në Beograd qëndron shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, ndërsa nga 8 deri më 11 tetor në Serbi mbahen ushtrimet e NATO-s për reagime të shpejta në situata emergjente në të cilat marrin pjesë 40 vende me 1000 ushtarë.

(Novosti, 4 tetor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

NGA E KA ORIGJINËN MBIEMRI GROPAJ?

Gropajt kanë qenë familje feudale shqiptare, pinjollë të së cilës përmenden që në shekullin XIII dhe në shekullin XIV si sundimtarë në krahinën rreth Ohrit. Më 1273, njërit prej tyre Pal Gropajt i njihet nga mbreti Karl Anzhu e drejta e zotërimit të disa fshatrave në krahinën e Dibrës (midis të cilave edhe Zerqani), ashtu siç i kishte zotëruar edhe nën sundimin bizantin. Më 1380 një Gropa tjetër përmendet

si sundimtar (zhupan) i Ohrit dhe dhurues i një kisha të pasur. Në dokumentacion pasardhësit e tyre i gjejmë të lidhur edhe me luftën e Skënderbeut.

Zaharia Gropa ishte komandant i shquar i asaj periudhe që u dallua në një sërë luftimesh me osmanët, sidomos për çlirimin e kalasë së Sfetigradit dhe në betejën e Vajkalit kundër Ballaban Pashës.

BETEJA POLITIKE SHUMË SHPEJTË NË PARLAMENT

TRE SKENARËT PËR DALJE NGA KRIZA

Nga 71 deputetë që aktualisht mbështesin ndryshimet kushtetuese, pushteti shpreson edhe në gjashtë deputetët e pakicave brenda VMRO-së për të çuar numrin në 77 deputetë. Por nga VMRO duhet siguruar edhe katër deputetë tjerë që të sigurohet shumica prej 2/3, aq sa duhen sipas rregullores së Parlamentit për të votuar ndryshimet kushtetuese

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 4 tetor - VMRO dhe LSDM kanë betonizuar qëndrimet partiake së fundit gjatë mbledhjeve të Kryesive qindore në lidhje me zgjidhjen e ngërçit politik pas mbajtjes së referendumit më 30 shtator. Por, për dallim nga partia në pushtet, që është unike në kërkesën e saj për implementimin e Marrëveshjes për emrin në Parlament, tek VMRO opozitare ka pasur përplasje në Kryesinë qendrore me çka ka rezultuar me shkarkimin nga funksioni të sekretarit të përgjithshëm, Stefan Bogoevski. Ndryshe, në Parlament pritet të ketë një betejë të ashpër politike mes pushtetit dhe opozitës.

Siç po shkojnë rrjedhat politike, së pari do të shikohet opsioni që të binden deputetët e VMRO-së që të marrin pjesë në seancë plenare dhe përmes votimit të fshehtë të votojnë pro ndryshimeve kushtetuese. Në këtë pikë, kuluareve politike flitet që të paktën 10 deputetë të shquhen për lojalitet ndaj "të fortit" të VMRO-së, Sasho Mihajkov, e të cilët mendohet se do të votojnë pro ndryshimeve kushtetuese si kompensim për amnisti nga akuzat e Prokurorisë Speciale në lidhje me aferën e përgjimeve. Një opsion tjetër që së fundmi nga opinionistët përmendet është edhe Qeveria teknike përmes një pajtimi kombëtar. Me këtë rast, marrëveshja politike do të mund të ndodh jo vetëm ndërmjet dy kampeve politike maqedonase që prej kohës janë thellësisht të përçarë, por do të ketë edhe një marrëveshje me subjektet politike shqiptare me pikë kryesore që gjuha shqipe të përmendet decidivisht në Kushtetutë dhe të mos lidhet me 20 përqindëshin deri më tani. Kjo, pasi shqiptarët do të përkrahin në mënyrë



REFERENDUMI, 30 DEPUTETË TË VMRO-SË KËRKOJNË KOMISION ANKETUES

Një grup prej 30 deputetëve të VMRO-DPMNE kanë parashtruar propozim-vendim për formimin e një Komisioni anketues për ekzaminimin e procesit të referendumit të mbajtur më 30 shtator. Sipas këtij propozim-vendimi, Komisioni anketues duhet të shqyrtojë kronologjinë e ngjarjeve dhe rrethanave në lidhje me referendumin, duhet të shqyrtojë se si janë harxhuar mjetet financiare nga Buxheti i Maqedonisë nga ana e deputetëve, Parlamenti, Qeveria dhe vetëqeverisja lokale në fushatën për referendum. Ky Komision do të

përpilojë edhe rekomandime që kanë për qëllim parandalimin e keqpërdorimeve të mjeteve financiare nga Buxheti, si dhe do të hulumtojë nëse gjatë referendumit ka patur parregullsi në realizimin e procesit dhe në ditën e mbajtjes së referendumit. Sa i përket strukturës së këtij Komisioni, sipas propozim-vendimit, Komisioni përbëhet prej 16 anëtarëve, prej të cilëve 8 anëtarë janë nga shumica parlamentare, ndërsa 8 të tjerë, duke përfshirë edhe kryetarin e Komisionit, janë nga opozita.

unanime mbrojtjen e identitetit dhe gjuhës maqedonase përmes votimit të ndryshimeve kushtetuese.

Ky opsion vështirë se mund të ndodh për faktin se do të merr kohë dhe afatet nuk premtojnë për të kryer obligimet për anëtarësim në NATO. Opsioni i tretë është ai i zgjedhjeve të parakohshme në rast se nuk arrihet shumica e kualifikuar prej dy tretave të votave. Nëse ndodh kjo, me gjasë do të ketë burgime të ish-strukturë së lartë të VMRO-së, përfshirë dhe vetë Nikola Gruevskin. LSDM në këtë variant do të paraqes VMRO-në si mbrojtës të krimit dhe korrupsioni dhe me shpresën se do të merrte vota në kampin shqiptar apo do të lidh koalicion parazgjedhor me BDI-në pa mos përrjashtuar as partitë tjera shqiptare, të arrijë numrin prej 81 deputetësh apo të paktën të afrohet dhe që VMRO të jetë më pas në një pozicion nënshtrues dhe e pafuqishme ti rezistojë ndryshimeve kushtetuese. Por në këtë drejtim, pikërisht BDI është skeptike se do të mund të arrihet deri tek numri 81,

edhe për faktin se VMRO- duke përdorur kartën nacionaliste, mund të dalë mirë në zgjedhje tek elektorati maqedonas. Deputetë të BDI-së thonë se opsioni më i mirë është votimi në Parlament i ndryshimeve kushtetuese përmes përkrahjes së deputetëve nga VMRO.

Kur jemi tek numrat, LSDM me 34 deputetë, plus dhjetë deputetët të BDI-së, një i RDK-së, grupi i Afrim Gashit nga Lëvizja BESA me tre deputetë, PDSH me Menduh Thaçin dhe Merale Uzeiri-Ferati, Partia e Ripërtrijes së Maqedonisë me dy, Partia e Lëvizjes së Turqve një, Partia e Pensionistëve dhe Qytetarëve të Bashkuar një, dy nga Partia e Re Socialdemokrate, një nga Partia për Emancipimin e Plotë të Romëve, tre nga Partia Liberale Demokrate, katër të pavarur, një nga Partia e Ardhmërisë Evropiane dhe një nga Partia Serbe, pra gjithsej 65 deputetë. Ndërkaq, mbështetje për ndryshimet kushtetuese shumica pritet të ketë edhe nga dy deputetët e Lëvizjes BESA - Fadil Zendeli dhe Teuta Biladhi, si dhe dy deputetët e Aleancës për Shqiptarët, nga Pançe

Minov i dhe Amdi Bajrami që dolën nga koalicioni me VMRO-në, gjë që numri shkon në 72 deputetë.

Por, një nga deputetët që po lëkundet e që është pjesë e pushtetit është vota e akademikut Ferid Muhic, meqë ky i fundit vazhdon të shprehet kundër Marrëveshjes për ndryshimin e emrit të shtetit me Greqinë. Prandaj, të sigurt janë vetëm 71 deputetë. Megjithatë shumica shpreson në përkrahje edhe të tre deputetëve të Partisë Socialiste - Vlladanka Aviroviq, Lupço Dimovski dhe Stojan Milanov, të deputetit nga Partia Demokratike e Serbëve në Maqedoni, Ivan Stoilkoviç, të deputetit nga Partia demokratike e turqve, Jusuf Hasanin dhe të deputetit nga Shoqata për Bashkimin Kulturor të Boshnjakëve, Zeqir Ramçilloviq. Me gjithë këto, numri shkon në 77 deputetë. Nëse këta të fundit do të dakordohen, duhet siguruar edhe katër deputetë që të arrihet shumica prej 2/3 sa duhen sipas rregullores së Parlamentit për të votuar ndryshimet kushtetuese. Mbetet të shihet nëse ndonjëri nga deputetët e VMRO-së që dalin

kundër qëndrimit partiak dhe të votojnë për ndryshimet kushtetuese, qoftë përmes ndonjë paze të lart politik, apo formave tjera jo të mira që në politikë edhe mund të përdoren në momente të caktuara.

Ndryshe, kryeministri Zoran Zaev ka përmendur datën 10 tetor kur duhet të dilet me qëndrim përfundimtar nëse ka arritur marrëveshje me deputetët e opozitës apo do të shkohet në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Për kryeministrin Zaev, kërkesat e VMRO-së për Qeveri teknike, sipas modelit të Marrëveshjes së Përzhinos me mandat 100 ditore, prokuror të ri publik dhe Komisione anketues në Parlament, janë plotësisht të papranueshme. Kjo, sipas asaj, që deklaroi të enjten gjatë një konference për media.

"As nuk ka arsye, as ka nevojë që të diskutohet për këso çështje. Vetë institucionet dhanë komente të tyre. Që të kërkohet Komision, i cili do të kontrollojë nëse referendumit ka qenë i ligjshëm, a ka pasur ligjshmëri në zbatimin e saj dhe ngjashëm në kushtet, a ka pasur ligjshmëri në zbatimin e tij dhe ngjashëm në kushte kur kryetari i KSHZ-së është nga VMRO, por edhe Gjykata Administrative në të cilën nuk është ëndërruar asnjë anëtar, vetë tregon se çfarë dëshiron me këto kërkesa", deklaroi Zaev. Ai paralajmëroi se në ditën në vijim do të diskutojë me deputetët në Parlament, por ashtu siç shtoi, në një atmosferë, më të mirë, më normale dhe më përgjegjëse. "Besoj se do të kemi ndonjë rezultat deri në fund të javës ose në fillim të javës tjetër. Diku rreth 10 tetorit do t'i tregojmë opinionit se cilat janë hapat e mëtejshëm. Shpresoj se do të kemi mundësi të kumtojmë se është siguruar shumica e nevojshme apo 2/3 e deputetëve", theksoi Zaev. Ndërkaq, ish-sekretari i përgjithshëm i VMRO-së, Petar Bogoevski, gjatë komentimit për shkarkimin që i bëri Komiteti Ekzekutiv, ndër të tjerash foli për skenarë të errëta të VMRO-së për të destabilizuar situatën politike në vend. "Thjeshtë papajtueshme janë dy konceptet tona, njëri për demokratizim, modernizim dhe evropianizim, ndërsa tjetri për klientelizëm, kriminalizim dhe karrierizëm autoritar në VMRO-DPMNE. Është e pamundur të dy të funksionojnë së bashku, ndërkaq me këtë rast - të avancohet puna e partisë në baza parimore", thekson Petar Bogoevski në statusin e tij në Fejsbuk. Sipas tij, VMRO në këtë moment tërësisht është në anë të gabuar të historisë, u nis, siç thekson Bogoevski, në drejtim tërësisht të gabuar dhe nuk është e mundur së bashku në trenin e njëjtë në drejtim të njëjtë.

IMPLEMENTIMI I MARRËVESHJES SË PESPËS, NËXTJE PËR INTEGRIMIN E RAJONIT

"Mbështetja e lartë e qytetarëve në referendum, paraqet momentum të fuqishëm për implementimin e Marrëveshjes së Pespës, me të cilën Republika e Maqedonisë në përgjithësi do t'i zhblllokojë integritet evropian dhe euro-atlantike", theksoi Osmani në takimet bilaterale me Ministrin për Evropë dhe Punë të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, Ditmir Bushati dhe Ministrin për Integritet Evropian të Republikës së Kosovës, Dhurata Hoxha në kuadër të Konferencën

e tretë për reformat e anëtarësimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor (WBAR). Osmani në takim me Ministrin për Integritet Evropian të Republikës së Kosovës, Dhurata Hoxha ai potencoi se ky progres, si dhe implementimi i Marrëveshjes së Pespës në përgjithësi, do të jetë një nxitje për gjithë rajonin, për kompromise thelbësore dhe të guximshme mes vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke i potencuar edhe marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë.

PASOJAT NGA ZGJEDHJET E PARAKOHSHME

RREZIKOHET FILLIMI I NEGOCIATAVE ME BE

Përderisa partitë politike LSDM dhe VMRO-DPMNE ende kalkulojnë me çështjen e ndryshimeve kushtetuese dhe vendimin për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, ekspertët juridik shprehen se zgjedhjet paraqesin bllokim të shumë proceseve. Mosrealizimi i plotë i rekomandimeve dhe vërejtjeve nga Raporti i Pribes është njëri prej rreziqeve më të mëdha me të cilën mund të ballafaqohen institucionet vendore

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 4 tetor - Mbjajtja eventuale e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në Maqedoni do të ndikojë në stagnimin dhe shtyrjen e shumë reformave. Shpërbërja e Parlamentit njëkohësisht pritet të bllokujë miratimin dhe ndryshimin e një sërë dispozitash ligjore që duhet të votohen deri në fund të muajit tetor. Për ekspertin juridik Naser Zyberi, zgjedhjet e parakohshme parlamentare gjithsesi se do të bllokoin reformat në gjyqësor dhe në këtë mënyrë do ta stagnonin këtë proces për një periudhë të caktuar. Kjo çështje sipas tij nënkupton se Maqedonia nuk do të jetë e gatshme që në qershor të vitit të ardhshëm të fillojë negociatat me BE.



SHPËRBËRJA E PARLAMENTIT I BLOKON PROCESIN

“Pa dyshim ndikim negativ këto zgjedhje mund të kenë edhe mbi procesin e skringut. Në rast të mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme e gjithë vëmendja e spektrit politik do të përqendrohet në procesin zgjedhor. Qeveria dhe Parlamenti do të jenë jashtë funksionit, gjegjësisht Qeveria do të jetë teknik e cila do të ushtroj funksione të detyrueshme për shtetin. Nga ana tjetër shpërbërja e Parlamentit paraqet bllokim të proceseve reformuese dhe integruese të shtetit. Gjithsesi, realizimi i këtyre zgjedhjeve të paralajmëruara do të prolongojë të gjitha proceset, duke filluar nga zbatimi i Marrëveshjes me Greqinë, fillimin e negociatave me BE-në dhe, çka është më kritikë, reformat e nisura në vend do të ngecin pa u rumbullaksuar

Përderisa partitë politike LSDM dhe VMRO-DPMNE ende kalkulojnë me çështjen e ndryshimeve kushtetuese dhe vendimin për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, ekspertët juridik shprehen

NASER ZYBERI

se zgjedhjet e parakohshme paraqesin bllokim të shumë proceseve domethënëse për të ardhmen e Maqedonisë. Mos realizimi i plotë i rekomandimeve dhe vërejtjeve nga Raporti i Pribes është njëri prej rreziqeve më të mëdha me të cilën mund të ballafaqohen institucionet vendase.

“Zgjidhja më e mirë për Maqedoninë, sipas meje që mos të vihem në këtë situatë është të bëhet një përpjekje përfundimtare e ndërmjetësuar prej faktorit ndërkombëtarëve (kuptohet se subjektet politike në vend nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për tejkalimin e kësaj situatë). Prandaj në këtë rast nevojitet intervenimi i të huajve, për të siguruar pro-

ces parlamentar për ndryshimet kushtetuese. Ky proces nënkupton përfshirjen e VMRO-së në proces, nënkupton proces të votimit të fshehtë për t'ju ikur mundësive të keqpërdorimit, pastaj të rezultatit të votimit nga strukturat e ndryshme. Në qoftë se kjo nuk realizohet atëherë pasojat negative do të jenë të mëdha për Maqedoninë”, thekson Zyberi.

ces parlamentar për ndryshimet kushtetuese. Ky proces nënkupton përfshirjen e VMRO-së në proces, nënkupton proces të votimit të fshehtë për t'ju ikur mundësive të keqpërdorimit, pastaj të rezultatit të votimit nga strukturat e ndryshme. Në qoftë se kjo nuk realizohet atëherë pasojat negative do të jenë të mëdha për Maqedoninë”, thekson Zyberi.

VËSHIRËSOHET MIRATIMI I LIGJEVE SISTEMORE

Mendimin e Zyberit se zgjedhjet e parakohshme nuk janë zgjidhja e problemit me të cilën ballafaqohet pushteti aktuale e ndanë edhe Zharko Haxhi Zafirov, nga Qendra për hulumtime dhe

analiza juridike. Duke i komentuar zërat se Parlamenti mund të shpërbëhet javën e ardhshme (10 tetor), Zafirov për gazetën KOHA, thotë se zgjedhjet e parakohshme të paralajmëruara se fundmi gjithsesi do të kenë pasojat negative mbi procesin e reformave në gjyqësor, posaçërisht kur flasin për planin aksionar të Strategjisë për reforma dhe kornizës kohore.

“Në rast të zgjedhjeve të parakohshme procesi i reformave të nisura do të prolongohet minimum për 90 ditë. Në këtë mënyrë do të vihet në pikëpyetje i gjithë procesi i kontrollit që duhet ta na e bëjë Bashkimi Evropian, me qëllim hapjen e kapitujve dhe fillimin e negociatave në qershor të vitit të ardhshëm. Nga aspekti teknik nuk besoj se zgjedhjet e parakohshme mund të ndikojnë mbi procesin e skringut, për arsye se në këtë proces momenti politik është më pak i përfaqësuar se sa ai teknik. Ky proces më tepër ka karakter teknik”, thotë Zafirov.

Për drejtuesit e Qendrës për hulumtime dhe analiza juridike, reformat në vend po realizohen në pajtim me agjendën e paraparë, me përjashtim të ngecjeve të vogla për disa dilema të caktuara. Megjithatë çështja më serioze të cilët e shpalos njohësi i zhvillimeve në gjyqësor Haxhi Zafirov, është se si do të vepohet kur në rend dite do të vije miratimi i ligjeve sistemore për të cilat nevojitet dy të tretat e votave.


Ndryshe, brenda këtij muaji siç ishte e paralajmëruar, nëse nuk ka ndryshime, në rend ditë në Parlament duhet të vendosen Ligji për gjykata, Ligji për Këshillin Gjyqësor, Ligjit për kundërvajtje dhe Ligjit për kontestet administrative, dispozita këto që miratohen me 80 vota të deputetëve.

RUSIA PËRSËRIT AKUZAT NDAJ PERËNDIMIT

MOSKËS I PENGON ANËTARËSIMI I MAQEDONISË NË NATO

Moskë, 4 tetor - Perëndimi, si edhe deri më tani, po përpiqet ta fusë Maqedoninë në NATO, madje edhe pas referendumit për ndryshimin e emrit, deklaroi zëdhënësjja e Ministrisë ruse të Punëve të Jashtme, Marija Zaharova, në britingun e rregullt javor. Siç transmeton TASS, Zaharova deklaroi se “qëllimi i dukshëm i vendeve perëndimore është që me çdo çmim ta fusin Maqedoninë në NATO”.

Reagimi i Zaharovës pason pas deklaratës së djeshme të sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, se Aleanca do ta pranojë Maqedoninë në radhët e saj



në fillim të vitit 2019, që sipas saj është e palejueshme, për shkak se “vendimin e parë duhet ta bëjnë parlamentet e Maqedonisë dhe Greqisë”. Pozicioni i Rosisë, tha

Zaharova, mbetet parimor dhe i pandryshuar-zgjidhje të përhershme për problemin mund të gjejnë vetë vendet, pa përzjerje dhe presione nga jashtë, për shkak se u

tregua se kjo nuk funksionon.

“Nëse flasim për mospërzjerje në punët e brendshme, atëherë nuk guxojmë të agjitojmë ‘për’ dhe ‘kundër’, në qoftë se flasim për referendumet. Nëse flasim për mospërzjerje në punët e brendshme dhe respektim të ligjit, duke i përfshirë edhe ndërkombëtarët, atëherë njeriu i parë i një blloku të shteteve nuk guxon të flasë për vendim që duhet ta sjellë parlamenti i një vendi”, deklaroi zëdhënësjja e Ministrisë ruse të Punëve të Jashtme. Ose, shtoi ajo, duhet të pranojmë se njëherë kjo mund të ndodhë dhe atëherë do të paraqitet sistemi i ri botëror.

Zaharova, gjithashtu, tha se është e befusuar nga rezultatet e komisionit të OSBE-së, që e ndoqën mbajtjen e referendumit në Maqedoni, transmeton Sputnik.

“Fushata e madhe propaganduese e Perëndimit prezantohet në mënyrë pozitive. Kjo nuk është vetëm normale, ajo është, gjithashtu, edhe plus. Çfarë do të ndodhte në qoftë se Moskë u bënte thirrje qytetarëve të Maqedonisë të votojnë? Kjo menjëherë do të kuptohej si përzjerje në punët e brendshme. Këto nuk janë vetëm standarde të dyfishta, por keqpërdorim i rregullave dhe normave sociale”, shtoi Zaharova.

Qytetarët e Maqedonisë posedojnë vetëm një të tretën e mirëqenies evropiane. Standardi jetësor i banorëve të Maqedonisë është sa 39 për qind e një qytetari mesatar evropian

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 4 tetor - Qytetarët në Maqedoni konsumojnë bukë dy herë më të lirë se mesatarja evropiane dhe tre herë më të lirë se mesatarja në Zvicër, si shtet me çmimet më të larta në kontinentin e vjetër.

Të dhënat e Entit të Statistikës së Maqedonisë tregojnë se niveli i çmimeve të frutave e perimeve në Zvicër është 3.6 herë më i lartë se në Maqedoni, ndërkohë që në vendin tonë çmimet e veshmbathjeve janë në nivelin 49 për qind të çmimeve të Islandës, që shquhet me çmimet më të larta në Evropë për veshmbathje. Edhe cigaret në tregun tonë janë në nivelin prej 26 për qind të mesatares evropiane, apo janë tetë herë më të lira se në Norvegji.

Ekonomistët thonë se përkundër çmimeve kaq të ulëta të më shumë artikujve në Maqedoni, megjithatë duke marrë parasysh harxhimet reale të jetesës në vend si dhe pagat e ulëta prej 250 deri 300 euro, renditemi ndër shtetet me fuqi shumë të ulët blerëse.

Me fjalë të tjera, qytetarët e Maqedonisë nga njëra anë së paku sipas statistikës, kanë harxhimet më të vogla, ndërsa nga ana tjetër gëzojnë një nga standardet më të ulëta të jetesës në Evropë që e dëshmon edhe ikja jashtë e qindra mijë qytetarëve jashtë shtetit.

Të dhënat statistikore tregojnë se qytetarët e Maqedonisë posedojnë vetëm një të tretën e mirëqenies evropiane, apo kanë standard që është për dy të tretat më i ulët në raport me një banor mesatar të BE-së. Ekonomistët thonë se në parim, kur flasim për standardin e qytetarëve në tërë botën, çdo herë merret parasysh një metodë e thjeshtë që tregon se sa për një pagë mesatare mund të blihen prodhime të ndryshme në një shtet.

"Gjatë krahasimit të standardit jetësor midis shteteve të ndryshme si tregues shfrytëzohet Prodhimi i Brendshëm Bruto për kokë banori i përshtatur me paritetin e fuqisë blerëse. Kjo nënkupton se të gjitha të ardhurat e një qytetari mesatar i përshtaten nivelit të çmimeve në një shtet, me qëllim që të krahasohet se sa të mira materiale apo edhe shërbime të ndryshme mund të blejnë në të vërtetë qytetarët me pagën e tyre. Një matës i tillë për Prodhimin e Brendshëm Bruto tregon se stan-

FUQIA BLERËSE NË EUROPE

MAQEDONIA DHE SHQIPËRIA,

MË TË VARFRAT



dardi jetësor i banorëve të Maqedonisë është sa 39 për qind e një qytetari mesatar evropian", thotë ekspertja Nikica Blazhevski.

Në ndërkohë, ngecja e madhe ekonomike të rajonit në raport me Bashkimin Evropian e tregojnë edhe analizat e tjera siç janë ato të institutit hulumtues gjerman GFK që mat konsumin dhe kursimin për kokë banori në shtete të ndryshme.

Indeksi i GFK-së, për vitin 2018, që merret me matjen e fuqisë blerëse të shteteve, e ka renditur Shqipërinë me 2793 euro dhe Maqedoninë me 3100 euro, ndër më të varftrat në Evropë. Përfshirje bën vetëm Mali i Zi me 5131 euro. Banorët e Serbisë

kanë në disponim 3383 euro, ndërsa ata të Bosnje e Hercegovinës kanë në disponim 3289 euro. Nga shtetet e tjera të rajonit, banorët e Kroacisë kanë në disponim 6969 euro, ndërsa ata të Sllovenisë kanë në disponim 10.750 euro. Sipas studimit të institutit gjerman për fuqinë blerëse në vitin 2017, evropianët kanë pasur në dispozicion mesatarisht 13.937 euro për person për shpenzime dhe kursim. Kështu Islanda, Zvicra dhe Lihtenshtajni kanë fuqi më të lartë blerëse, ndërsa bashkë me Maqedoninë, në grupin e shteteve me fuqinë më të ulët blerëse janë edhe Shqipëria, Bullgaria, Bosnje Hercegovina, Serbia por edhe Bjellorusia, Moldavia dhe Ukraina.

FINANCAT NË KONDICION TË MIRË

Financat publike janë transparente, borxhi publik është nën kontroll, ndërsa në procedurë janë edhe reforma për përpërimin e sistemit financiar publik. Këtë e theksoi ministri i Financave Dragan Tevdovski në Konferencën e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, duke folur për reformat në sistemin e financave publike. Ministri theksoi se financat publike tani janë në kondicion të mirë, por edhe se janë përgatitur masa për përmirësim të sistemit. "Me Programin për reforma të financave publike janë papaparuar një varg masash për efikasitet dhe efektivitet më të madh të shpenzimeve publike, qëndrueshmëri e borxhit dhe transparencë më e madhe. Përmes ligjit të ri për buxhete, sistem të përmirësuar për furnizime publike, publikim të shpenzimeve të ueb platformës dhe masa të tjera, do të përmirësohet menaxhimi me financat publike. Me këtë do të sigurohet rritje ekonomike stabile dhe e qëndrueshme, e me këtë edhe standard më i mirë për qytetarët", tha Tevdovski.

Të shfrytëzohen mundësitë e Ligjit për energjetikë

Ohër, 4 tetor - Kompanitë energjetike të Maqedonisë duhet t'i njohin mundësitë që i ofron Ligji për energjetikë, me qëllim që të bëhen më konkurruese në rajon, të bëjnë transicione interne dhe të brendshme në punën e tyre që të adaptohen në botën e re energjetike dhe në transicionin e ri energjetik. Këtë e porositi zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev, në fjalimin e tij në hapjen e konferencës ndërkombëtare "Energjetika 2018" që nga sot e deri më 6 tetor po mbahet në Ohër në organizim të Shoqatës së Ekspertëve Energjetikë të

Maqedonisë dhe të Asociacionit Energjetik të Maqedonisë. "Energjetika si qarkullim i industrisë është thelbi i cili duhet të planifikohet në mënyrë afatgjatë. Për fat të keq kjo fushë shumë vite ishte lënë pas dore në Republikën e Maqedonisë dhe vlerësoj se duhet t'i jepet kujdes i nevojshëm, sepse nëse për energjetikën nuk keni plan për 10, 20, 30 vitet e ardhshme sa parashikon strategjia energjetike në këtë mënyrë nuk keni kurrfarë plani. Energjetika nuk planifikohet prej sot për nesër, as për shtet për vitin e ardhshëm. Duhet të planifikohet në afat më të

gjatë, nëse dëshironi ta keni si të qëndrueshme dhe serioze në një shtet", theksoi Angjushev. Energjetika, theksoi ai, do të zhvillohet në drejtim të bursave rajonale për energji elektrike, infrastrukturë në rritet gazsjellëse dhe botën globale të industrisë së naftës. Zëvendëskryeministri Angjushev pret që deri në fund të vitit të përgatitet edhe ligji për efikasitet energjetik, kur do të vendoset në debat publik, duke u refuzuar të gjithë të marrin pjesë dhe të japin kontribut të veti në formulimin e plotë të zgjidhjes ligjore.

KRONIKË

Kapet hajni në vendngjarje

Të enjten në orët e para të mëngjesit në rrugën e "Ilindenit" në Gostivar, pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, Stacioni policorë në Gostivar, kanë privuar nga liria personin N.I. 34 vjeçar nga fshati Debresh. I njëjti rreth të mërkurën mbrëma orës 23.00, ka tentuar të kryejë vjedhje të rëndë në një objekt tregtarë në Gostivar, në rrugën "Goce Dellçev" por e ka vërejtur pronari i objektit dhe menjëherë ka filluar të ikë. Pronari i objektit ka vrapuar pas tij dhe e ka kapur, por më pas e ka lëshuar, sepse i njëjti e ka kërcënuar se do ta sulmoj fizikisht. Personi N.I. 34-vjeç, është mbajtur në Stacion policorë Gostivar, dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit.

Ndalohe tre të rinj, kapen me marihuanë

Të enjten mbrëma rreth orës 20 e 40 minuta, në rrugën lokale në fshatin Sedllarcë e Epërme, pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, kanë vërejtur një veturë të parkuar të tipit "Opel Vektra" me targa të Tetovës, në të cilën kanë qenë tre persona, të moshës 24 vjeçare nga edhe atë Sh.I. S.S. dhe F.I. të gjithë nga fshati Sedllarcë e Epërme. Gjatë kontrollit ndaj tyre, tek personi S.S. policët kanë gjetur një ziper qese me marihuanë. Tre personat janë privuar nga liria dhe janë mbajtur në Stacionin policorë për zbardhje të plotë të rastit.

Aksidentohet një fëmijë 8-vjeçar

Të mërkurën rreth orës 18 e 10 minuta, në rrugën "180" në Tetovë, vetura e tipit "Folksfagen Passat" me targa të Tetovës, e drejtuar nga personi F.M. 31 vjeçar nga Tetova, ka aksidentuar një këmbësor 8 vjeçar nga Tetova. Fëmija i lënduar, me të njëjtën veturë është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës, për marrjen e ndihmës së parë mjekësore. Janë kryer hetimet në vendin e ngjarjes, dhe punohet në zbardhjen e shkakut të aksidentit, si dhe rrethanat dhe detajet tjera në veçanti.

Shkup, 15 aksidente për 24 orë

Tetëdhjetë e dy shoferë në Shkup kanë drejtuar automjetin më shpejtësi më të madhe se e lejuara në 24 orët e fundit tregojnë të dhënat e buletinit policor të SPB Shkup. Gjatë 24 orëve të fundit kanë ndodhur edhe 15 aksidentet trafikur prej të cilave në tetë më lehtë janë lënduar 11 persona, ndërsa në shtatë është shkakuar dëm material. Policia e trafikut i ka përjashtuar nga komunikacioni pesë shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, 14 para se të marrin patentë shoferin dhe një shofer fillestar. Nga komunikacioni janë përjashtuar edhe 15-të automjete të parregjistruara dhe një automjet i cili ka qenë i stërngarkuar. Janë dhënë 102 dënime për parkim të parregullt, ndërsa me automjetin special "karrotrec" janë ngritur 72 automjete. Sipas buletinit policor, gjashtë shoferë në rajonin e Shkupit kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, ndërsa tejkallim i parregullt është vërejtur në tre automjete. (U.H)

NË SHKUP U MBAJT FORUMI "DOING BUSINESS WITH FINLAND"

MUNDËSI PËR PARTNERITETE TË REJA

Në periudhën prej vitit 1997-2017, hyrja e të ardhurave nga Finlanda arrin vlerën 1.4 milion euro

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 4 tetor - Bashkëpunimi ekonomikë midis Maqedonisë dhe Finlandës është në nivel shumë të ultë por ekziston hapësirë e mirë për rritjen e këmbimit tregtar midis këtyre dy vendeve. Ky ishte konstatimi i përbashkët i komunitetit të biznesit nga Finlanda dhe atyre nga Maqedonia në forumin e biznesit me titull "Doing Business with Finland" që u mbajt të enjten në Shkup organizuar nga Oda Ekonomike e Maqedonisë. Ministri i Ekonomisë Kreshnik Bekteshi në këtë forum të biznesmenëve nga Finlanda u prezantoi klimën e biznesit në Republikën e Maqedonisë, si dhe mundësitë për bashkëpunim me kompanitë finlandeze të cilët janë në kërkimin e sipër partnerë biznesi në Maqedoni, ndërsa si sektorë të cilët do të mund të vendosnin bashkëpunim të ndërsjellët janë sektori i tekstilit, industrinë e ushqimit dhe metalit dhe mjedisin jetësor.

"Dera e hapur e vendit tonë drejt Evropës, ka sjellë miqtë tanë të komunitetit finlandez të biznesit për një takim me biznesmenë nga Maqedonia. Jam i bindur se ky forum i biznesit do të rezultojë me partneritete të reja të biznesit duke filluar me forma të reja për zgjerimin e bashkëpunimit në sektorë të ndryshëm, të cilat do të kontribuojnë në rritjen e tregtisë së përgjithshme mes të dy vendeve, por edhe investime të reja nga Finlandë, si rezultat i mjedisit të shëndoshë për investitorët, stabilitet makroekonomik dhe, kushte të barabarta e transparente si për investitorët vendas ashtu edhe për ata të huaj, bazuar në kriteret e rregulluara me ligj, të cilat çdo investitor paraprakisht i ka të njohu-



ra dhe e din se çfarë lloj mbështetje mund të pritet nga shteti", tha ministri i Ekonomisë Bekteshi. Sipas ministrit ka hapësirë të madhe për përmirësimin e bashkëpunimit, duke marrë parasysh faktin se tregtia e përgjithshme midis dy vendeve është relativisht e vogël.

"Për periudhën 2015-2017, e cila arrin prej 9.1 milion euro në 16.8 milion, përderisa tek investimet, në periudhën prej vitit 1997-2017, hyrja e të ardhurave nga Finlanda arrin vlerën 1.4 milion euro që paraqet 0.03 për qind të numrit të investimeve të huaja direkte në Republikën e Maqedonisë. Finlandës. Ky takim duhet të kontribuojë në gjetjen e mundësive të reja për thellimin e bashkëpunimit mes të dyja vendeve", tha Bekteshi.

Perti Ikonen ambasadori i Finlandës në Serbi, përgjegjës edhe për Malin e Zi dhe Maqedoninë nënvizoi se Finlanda është një nga vendet lidere në botë në më shumë industri dhe është e njohur për klimën stabile dhe të begatë të biznesit, fuqinë eksportuese dhe marrëdhëniet e suksesshme të biznesit si me vendet nordike ashtu edhe me tregun e vetëm evropian, ndërsa për momentin Maqedonia kryesisht importon prodhime tekstili por që ka interes të shtuar edhe për industrinë e plastikës dhe makinerisë.

"Me procesin e pranimit të Maqedonisë në BE, dy vendet tona po afrohen edhe më shumë. Bashkëpunimi tregtar nuk është në nivelin më të lartë dhe shpresoj që sot ne do të gjejmë mënyra dhe mundësi të reja për të zgjeruar dhe rritur bashkëpunimin tonë dy-palësh. Jam i bindur se ashtu siç do të avancojë procesi i aderimit të Maqedonisë drejt BE-së do të rriten edhe kapacitetet e saja ekonomike me të gjitha vendet e Bashkimit", theksoi Ikonen.

Ndërsa Antoni Peshev, kryetar i Kuvendit të Odës Ekonomike të Maqedonisë, njëherit dhe organizator i këtij forumi theksoi se takimi i sotëm në të ardhmen do të rezultojë me përmirësimin e bashkëpunimit ekonomik jo vetëm me Finlandën por edhe me vendet tjera evropiane. "Takimi me biznesmenët finlandez është rezultat i më shumë kontakteve ndërkombëtare që shpresojmë të përmirësojnë bashkëpunimin me vendet evropiane dhe mundësi e bukur për t'u njohur me potencialin për bashkëpunim me Finlandën, e cila po shënon rritje, por që ende nuk është e strukturuar dhe konstante ndërsa ne kemi produkte dhe mundësi për të balancuar shkëmbimin tregtar që është rreth 12 milionë euro", tha Antoni Peshev, kryetar i Kuvendit të Odës Ekonomike të Maqedonisë.



EVN promovoi projektin "Elektromobiliteti"

Shkup, 4 tetor - Duke ndjekur trendet globale, EVN filloi me krijimin e kushteve për shfrytëzimin sa më të madh të makinave elektrike në Maqedoni, duke filluar me ndërtimin e infrastrukturës ndërkombëtare për mbushje të makinave elektrike. "Udhëtimet e gjata me këto lloj makine janë pothuajse të pamundur, për shkak të kufizimeve të teknologjisë aktuale të makinave elektrike, si dhe për shkak të infrastrukturës së përshtatshme të mbushjes së makinave me energji elektrike. Për këto arsye, në bashkëpunim me komunat në Maqedoni EVN instaloi mbi 40 stacione të mbushjes së makinave elektrike në Shkup dhe në 17 qytete tjera të Maqedonisë", tha Shtefan Peter kryetar i Bordit drejtues të EVN Maqedoni. Mbushësit, sipas Peter, janë vendosur në lokacione qendrore, në parkingje të disponueshme publike si dhe në objekte biznesi të frekuentuara, si hotele, restorante dhe qendra tregtare.

"Tash e tutje të gjithë pronarët e makinave elektrike në Maqedoni dhe jashtë vendit do të mund të udhëtojnë pa pengesë në çdo drejtim të vendit si dhe jashtë tij. Me këtë u mundësojmë mobilitet më të madh pronarëve të makinave elektrike sepse nuk do jenë të detyruar t'i mbushin makinat në shtëpitë e tyre por njëkohësisht këtë mund ta bëjnë edhe në stacionet për mbushje të instaluar në të gjitha qytetet e Maqedonisë", tha Shtefan Peter, kryetar i Bordit drejtues të EVN Maqedoni. (Z.V)

BANKA BOTËRORE PUBLIKOI RAPORTIN

EKONOMIA VARET NGA REFORMAT

Shkup, 4 tetor - Ekonomia e Maqedonisë në mënyrë të konsiderueshme u rikuperua në vitin 2017 dhe shihen lëvizje pozitive të mbështetura prej investimeve private dhe konsumit. Pritet gjatë këtij viti ekonomia të shënojë rritje prej 2.5 për qind, vitin e ardhshëm 2.9 për qind dhe vitin 2020, 3.2 për qind. Për pritjet e këtyre mund të ndikojë shkelja e procesit reformues nën ndikimin e cikleve zgjedhore dhe mosplotësimin e konsolidimit fiskal.

Ky është vlerësimi i Bankës Botërore në raportin e rregullt ekonomik për Ballkanin perëndimor,

që sot u prezantua në Zyrën e këtij institucioni ndërkombëtar financiar në Shkup.

"Maqedonia e shënoi progresin më të madh prej gjashtë vende ballkanike nga viti i kaluar. Deri në vitin 2020 pritjet rritje më graduale, megjithatë ndjeshmëria e supozimeve për pasqyrën tonë është përsheptimi i procesit të inkuadrimin në BE dhe momenti i ruajtjes së reformave", tha drejtori i Zyrës së Bankës Botërore në Maqedoni, Marko Mantovaneli, duke shtuar se do t'i ndjek gjendjen dhe do t'i marrin parasysh gjatë projektimeve të ardhshme. Ai shpreson

se nëse ka paqëndrueshmëri politike dhe pasiguri dhe nëse ky ka një ndikim minimal që do të shfaqet nga përsheptimi i proceseve të reformës atëherë Maqedonia do të mbetet në rrugën e rritjes pozitive. Nëse paqëndrueshmëria politike vazhdon, ka rrezik që kjo trajektore pozitive nuk do të jetë aq e shpejtë dhe pozitive sa pritej.

Mantovaneli theksoi se çdo vend kalon nëpër proceset e veta politike ndërsa ky proces, tha ai, është shumë i rëndësishëm për Maqedoninë, sepse bëhet fjalë për një moment kritik dhe çështje kritike. Në afat të shkurtër, Maqedo-



ninë e këshillojnë për fokusimin mbi stabilizimin e borxhit publik, që sivjet u rrit në 49 për qind, që është e mundur nëse zbatohet ndonjë aftësim i caktuar.

Sipas tij, është mirë që këtë vit është zvogëluar deficitin dhe me atë krijohet hapësirë për investime produktive në kapitalin njerëzor dhe nevojë më e vogël që të finan-

cohen deficitet për detyrimin e obligueshëm. Banka Botërore rekomandon reformë strukturore të fokusuar në krijimin e rrethimit për sektor privat produktiv dhe me konkurrencë, ndërsa nga ana tjetër investim në kapitalin njerëzor. Banka Botërore pret se borxhi publik këtë vit do të jetë deri në 50 për qind.

KANCERI I GJIRIT NË MAQEDONI

RRITET NUMRI I TË PREKURVE

Për një vit paraqiten mbi 700 raste, por ndërgjegjësimi i grave për kontroll ndikon në diagnostifikimin e hershëm të sëmundjes

Koha

Delvina KËRLUKU

Shkup, 4 tetor - Kanceri i gjirit është një prej sëmundjeve kanceroze të gratë, por edhe shkaktari më i shpeshtë i vdekjes të gratë e moshës 45-55 vjeç. Rëndësia e zbulimit të hershëm është një faktor shumë me rëndësi në parandalimin e kësaj sëmundje dhe kjo sidomos mund të bëhet te femrat e reja. Në Klinikën e Onkologjisë në Shkup, dr. Ilir Ismaili thotë për gazetën KOHA, se pacientja e tij më e re është një vajzë 18 vjeçare e diagnostifikuar me kancerin në gj, por gjendja e saj është stabilizuar dhe vazhdon të kurohet.

Në Maqedoni ka rritje të numrit



të prekur nga karcinomi në gj. Për një vit paraqiten mbi 700 raste, por ndërgjegjësimi i grave për kontroll ndikon në diagnostifikimin e hershëm të sëmundjes.

"Fatkeqësisht viteve e fundit kemi një tendencë në rritje të numrit të rasteve të rejave të karcinomit të gjendrës së gjirit. Statistikat thonë se në vit kemi rreth 750 raste të reja të diagnostikuara me këtë sëmundje. Por në anën tjetër kemi edhe një tendencë të vetëdijesimit të popullatës për shkak të interesi-

mit të mediave që të informojnë pacientët me repartet për kontroll të sëmundjeve malinje, në përgjithësi, dhe të karcinomit të gjirit, në veçanti", nënvizon onkologu Ismaili. Ai saktëson se Maqedonia është lider i standardeve dhe kushteve më të mira në rajon, ndonëse për ta arritur nivelin evropian duhet edhe shumë punë.

Sipas onkologut, çdo grua duhet të bëjë kontrolle duke përfshirë ehon, një ose dy herë në vit, pas moshës 25 vjeçare, kurse pas moshës 35

vjeçare deri në 40 vjeçare të fillohet me skringing ose mamografi, çdo dy deri tre vjet. Këto metoda tregojnë nëse ka ndonjë problem, ndryshim apo jo, ndërsa çdo ndryshim duhet të verifikohet me citopunkcion, për të zvogëluar numrin e biopsive të panevojshme. Nga shoqata për luftën kundër kancerit "Borka - për çdo ditë të re", thonë për gazetën KOHA se në Maqedoni ka kushte për shërimin nga kanceri në gj, mirëpo duhet të vazhdohet të trajtohet me më siguri pacienti, tera-

pitë e reja të vendosen në listën pozitive. Nga kjo shoqatë thuhet se 1 në 8 gra mund të diagnostikohen me kancer të gjirit në një fazë të caktuar të jetës së tyre. Në Maqedoni, shkalla e vdekshmërisë së kancerit të gjirit është ende më e lartë në krahasim me vendet e BE-së. Falë zbulimit në kohë dhe trajtimit të duhur, gjithnjë e më shumë gra mund të shërohen tërësisht dhe të provojnë se kanceri i gjirit, si sfidat e tjera të jetës, mund të tejkalohet. Marshi "Përpara Rozë" është një ngjarje unike e kësaj që mbahet në muajin tetor, si muaji i luftës së kancerit në gj, që organizohet nga shoqata Borka në bashkëpunim me Ambasadën e Amerikës. Bashkimi i të gjithëve që kanë përjetuar këtë sëmundje, miqtë e tyre, si dhe të gjithë qytetarët e Maqedonisë, me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit për luftën kundër kancerit të gjirit. Ky është funksioni i këtij marshi dhe apelohet që të bëhet pjesë çdo qytetar në këtë nismë, të ecin së bashku për atë që luftojnë, për atë që besojnë, për atë që u duhet shpresë dhe mbështetje, po edhe për nder të atyre që humbën. Ky marsh, kundër kancerit në gj do të mbahet më 7 tetor, në Shkup.

Nga Shoqata e të sëmurëve nga leukemia kronike mieloide thonë se në Maqedoni, sot ka mbi 130 të sëmurë nga leukemia, kurse rreth 30 për qind e tyre janë pa terapi të nevojshme, me tendencë që kjo përqindje të rritet për çdo vit

Shkup, 4 tetor - Pacientët të cilët viteve të kaluara me shpenzime të Fondit për Sigurim Shëndetësor janë mjekuar në qendra të huaja evropiane për transplantim, tani këtë mund ta bëjnë në kuadër të Klinikës Universitare për Hematologji në Shkup. Mirëpo, pavarësisht se konsiderohet faqe e re në historinë e hematologjisë së Maqedonisë si edhe hap i rëndësishëm përpara për shëndetësinë publike në tërësi, megjithatë, ky shërbim nuk është për çdonjërin. Një banor i fshatit Boshticë në komunën e Zhupës thotë për gazetën KOHA se bashkëshortja e tij vuan nga sëmundja akute - leukemia limfoblastike. Asaj i nevojitet në mënyrë urgjente transplant i qeli-

SFIDAT E MOSPËRBALLIMIT TË LEUKEMISË

RRETH 30 PËR QIND E TË SËMURËVE, PA TERAPI TË NEVOJSHME



zave burimore, por në pamundësi që e gjitha kjo të bëhet në Maqedoni, është e nevojshme e nevojta të realizohet në Gjermani, në vlerë prej 250.000 euro. Bashkëshorti i saj (Elmini) edhe pse i është drejtuar Klinikës së Hematologjisë, në Shkup, nuk ka gjetur rrugëzgjidheje dhe ka kërkuar ndihmë nga familjarët, miqtë, njerëz human dhe kompaninë e ndryshme.

"Nuk më dhanë mundësinë, që bashkëshortja të bëjë transplantimin e qelizave amë në Shkup. Fondi nuk jep ndihmë, sepse kërkon vlerësimin dhe mendimin e komisionit mjekësor në kuadër të FS-SHM-së, ndërkohë që na është refuzuar dhënia e këtij vlerësimi dhe mendimi", thotë Elmin Shahinoski, për gazetën KOHA. Pasi nuk gjetëm, 'derman' këtu, vendosëm të shkojmë në Gjermani, me finan-

ca familjare dhe njerëzve human, dhe të kthehemi sërish në Maqedoni pas diagnostifikimit të sëmundjes bashkë me caktimin e terapisë. Por sërish u zhgënjëm, sepse mjekët e këtushëm nuk e trajtuan fare pacientin dhe për pasojë u detyruam sërish të kthemi në Gjermani, ku dhe u konstatua se sëmundja përsëri i është kthyer", thotë Shahinoski.

Trajtimi i leukemisë në Maqe-

doni po përcillet me probleme të shumta, edhe për faktin se mungojnë ilaçet e reja në listën pozitive. Këtë për gazetën tonë e konfirmoi edhe kryetari i Shoqatës së të sëmurëve nga leukemia kronike, Pepo Levi. Ka shumë pacientë që vuajnë me vite nga kjo sëmundje dhe ata për shkak të ardhurave të ulta nuk mund të përballojnë koston e kurimit. Madje ka raste që për një ilaç nevojiten katër vite që të sigurohet.

Robert Bekirovski, drejtori i Agjencisë për barna dhe pajisje medicinale MALMED, theksoi se qasja deri të barnat për këtë grup të njerëzve do të jetë në nivelin më të lartë. Por nga Shoqata e të sëmurëve nga leukemia kronike mieloide thonë se në Maqedoni sot ka mbi 130 të sëmurë nga leukemia, kurse rreth 30 për qind e tyre janë pa terapi të nevojshme, me tendencë që kjo përqindje të rritet për çdo vit. (D.K)

Manipulatorët përdorin lloj-lloj metoda për të mashtruar pleqtë, ndërsa më shpesh prezantohet si shok të djemve të tyre kurse për fat të keq në këtë grackë bien personat e moshuar

MANIPULATORËT ENDE OPEROJNË NË POLLOG

TË MOSHUARIT "VIKTIMË" E MASHTRUESVE



Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 4 tetor - Të moshuarit shpesh herë bien pre e mashtrimeve të ndryshme në qytetin e Gostivarit. Zakonisht këta raste janë regjistruar viteve të kaluara por dukshëm janë prezente edhe këtë vit. Mashtrimet ndaj pleqve kryhen zakonisht në ditë tregu ose ditën kur merren pensionet, thonë burime policore, kur edhe kjo kategori e qytetarëve frekuenton pjesët qendrore të qytetit. Sipas raporteve të deritanishme policore, në qytetin e Gostivarit, gjatë këtij viti janë regjistruar disa raste të mashtrimeve ku "viktimë" kanë qenë pleqtë apo të moshuarit, të cilët duke u besuar mashtruesve në rrëfimin e tyre, u kanë dhënë para. Rrëfimet për kinse bëhet fjalë për shtetas të huaj të cilët kanë pësuar aksident në trafik dhe u nevojiten mjete për të paguar dëmin, në këmbim ata u kanë dhënë orë dore prej ari, shpeshherë pleqtë u kanë besuar por më vonë kanë kuptuar se janë mashtruar.

Këto lloje të mashtrimeve nuk janë të panjohura në hapësirat e Tetovës dhe Gostivarit, sidomos ata që kanë të bëjnë me të ashtuquajturat fallxhore të cilët tregojnë ardhmërinë por nuk kanë munguar edhe mashtrimet se kinse ofrohen shërbime mjekësore. Mashtrimet e kështilla janë hasur jo vetëm në qytete por edhe në fshatra por për kohë të shkurtër janë zbardhur ndërsa ma-

shtruesit janë paditur në mënyrë adekuate.

Gjatë viteve të kaluara poashtu në këtë rajon kanë qenë prezente dhe të ashtuquajturat mashtrime me sigurimet apo mashtrimet për marrje të kredive dhe shërbime tjera bankare, thonë nga policia e Tetovës. Rastet e mashtrimet të kësaj natyre janë shtuar kohëve të fundit ndërsa më tragjike është se të njëjtat regjistrohet në rajonin qendror të qytetit eTetovës dhe Gostivarit ku edhe frekuentimi është më i madh, por kryerësit e këtyre veprave vepronë shpejt dhe pastaj largohen. Manipulatorët përdorin lloj-lloj metoda për të mashtruar pleqtë, ndërsa më shpesh prezantohet si shok të djemve të tyre kurse për fat të keq në këtë grackë bien personat e moshuar.

"Bëhet fjalë për mashtrime të ndryshme, të cilat individët në mënyrë të shkathtët i kanë kryer duke shfrytëzuar rrethana të caktuara që u kanë shkuar për dore. Në mesin e

mashtrimeve gjatë vit të kaluar bëjnë pjesë edhe rrëfimet e sajua, të cilëve u kanë besuar në më shumë raste personat e moshuar. Në dhjetëra raste të mashtrimeve, mashtruesit u janë prezantuar viktimave si shtetas të huaj, se nuk i dallojnë aspak paratë dhe kanë kërkuar ndihmë kinse kanë bërë aksident dhe duket që të paguajnë vlerën e aksidentit, Si garancë mashtruesit kanë lënë orë dore ose bankënota të rrejtshme dhe më pas janë larguar me shpejtësi nga vendi i ngjarjes", bëjnë të ditur nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë.

Policia e Tetovës edhe një herë apelon tek qytetarët që të jenë të kujdesshëm ku u afrohen njerëz të panjohur dhe u ofrojnë prodhime dhe shërbime me prejardhje të dyshimtë. "Apelohet poashtu që të mos huazohen personave të panjohur dokumentet personale apo kopjet nga të njëjtat, sepse mund të keqpërdoren shumë lehtë. Nëse përballen me këto raste, qytetarët duhet

menjëherë që të njoftojnë stacionin më të afërt, me çka do të ndihmojnë në zbulimin dhe sanksionimin e mashtruesve potencial", theksojnë nga SPB-ja e Tetovës.

Sipas raporteve të deritanishme të policisë, më shumë këta mashtrime ndodhin në pjesën qendrore të qyteteve ku ndodhen edhe institucione të ndryshme publike ku frekuentimi është më i madh por nuk mungojnë edhe mashtruesit në vendet periferike siç janë stacionet e trenave dhe autobusëve. Gjithnjë në këtë drejtim mashtrimet ndodhin në vendet më të frekuentuara ku paguhen faturat e rrymës elektrike, para postës, afër bankave apo tregjeve. Më të rriturit dhe jo gjithmonë jo mirë të udhëzuarit, shumë lehtë bien pre e këtyre tregimeve, dhe pa u menduar mirë iu japin para të panjohurve për shërbimet dhe produktet e ofruara nga mashtruesit, pasi kuptojnë se janë mashtruar, më vonë i denoncojnë rastet në Policinë e Tetovës

Në shtator, 1612 kundërvajtje në trafik

Tetovë, 4 tetor - Pjesëtarët e policisë nga Sektori për punë të brendshme në Tetovë, gjatë muajit të kaluar në zonën më të gjerë të Tetovës, gjithsej kanë zbuluar 1612 kundërvajtje në trafik, që do të thotë se ka pasur 63 kundërvajtje më shumë se periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Për shkak të kundërvajtjeve të konstatuara në këtë rajon, nga trafiku janë larguar 131 vetura, ku pjesa më e madhe janë për shkak të regjistrimit të skaduar, gjegjësisht për regjistrim të parinovuar mbi 30 ditë edhe atë 79 vetura, dhe teknikisht të parregullta 52 vetura. Në periudhën e njëjtë, nga komunikacioni janë larguar gjithashtu edhe 229 vozitës, nga të cilët 128 pa leje për vozitje, apo leje adekuate, 30 vozitës kanë drejtuar nën ndikim të alkoolit, si dhe 70 vozitës fillestarë, të cilët nuk u janë përmbajtur kufizimeve të parapara ligjore, dhe 1 vozitës i cili ka drejtuar veturë gjatë masës mbrojtëse ndalesë. Këto si dhe lloje të tjera të kundërvajtjeve të zbuluara gjatë kontrolleve dhe aktiviteteve të muajit shtator, në zonën e Tetovës, kanë përfunduar me sanksionimin dhe me 544 fletëpagesa për kundërvajtje, 861 fletëpagesa të detyrueshme për kundërvajtje, si dhe janë përgatitur edhe 198 vërejtje me shkrim dhe 6 kundërvajtje ndaj personave juridik. Gjatë shtatorit, përkohësisht janë konfirmuar 102 leje për vozitje dhe 67 leje qarkullimi.

Në Dibër, dy shkolla edhe zyrtarisht me emra shqip

Dibër, 4 tetor - Këshilli i Komunës së Dibërës në seancën e djeshme të rregullt miratoi vendime për dhënien e pëlqimit për riemërimin e dy shkollave në qytet. Vendimet kanë të bëjnë për shkollën fillore komunale "Bratstvo edinstvo" e cila riemërohet në "Penestia", sipas historianëve shqiptarë emri i vjetër i Dibërës, dhe shkollën e

mesme komunale "Zdravko Çoçkovski" në "28 Nëntori", dita e Pavarësisë së Republikës së Shqipërisë dhe ditë e flamurit kombëtar shqiptar. Pëlqimi për riemërimin dhe ndryshimin e statuteve të shkollave kaloi edhe me ruajtjen e numrit të nevojshëm të votave sipas Badenterit. Vendimi për ndryshimin e emrave të dy shkollave,

gjithashtu me Badenter, u votua edhe në vitin 2012 nga këshilli i atëhershëm komunal. Në seancë këshilltarët kërkuar nga kryetari i këshillit, Bashkim Mashkulli, që të ndërmarë veprime tek kryetari i komunës dhe sektori për financa në komunë të paguhen kompensimet e këshilltarëve që kanë ngelur, si edhe më-

ditjet e nevojshme për personat e angazhuar në këshillat zgjedhorë të zgjedhjeve lokale të vitit të kaluar. Pesëmbëdhjetë këshilltarëve të këshillit aktual, duke e përfshirë edhe seancën e sotme sipas Mashkullit nuk u janë paguar katër, ndërsa atyre të përbërjes paraprake tre kompensime për këshilltarë.

Konfiskohet 45 kg drogë e destinuar për Greqi dhe Turqi

Shkup, 4 tetor - Në një automjet me targa nga Shqipëria në kalimin kufitar "Bogorodica" Drejtoria e Doganave dje zbuloi dhe konfiskoi rreth 45 kilogramë drogë. Shoferi dhe bashkudhëtarja e tij, shtetas të Republikës së Shqipërisë kanë marrë kallëzim penal për prodhimin dhe shitjen e 34,6 kilogramë

marihuanë dhe 9.8 kilogram hashash. Siç informuan sot në pres konferencë nga Drejtoria e Doganave, dje në orën 12:30 në kalimin kufitar "Bogorodica" në dalje nga Maqedonia në një automjet me targa nga Shqipëria i drejtuar nga O.L dhe bashkudhëtarja A.J. nga Shqipëria, doganierët gjatë kontrollit

në dyshemenë e automjetit kanë gjetur 49 paketime me materie të gjelbër të mbështjellë në një shirit të zi. Shefja e shërbimit për luftë kundër kontrabandimit Liljana Zhivkoviç-Davitkova qartësoi se droga e gjetur ishte e destinuar për tregun në Greqi dhe Turqi, ndërsa me prejardhje nga Shqipëria.



Në Europë apo në Euroazi?

Nga
Fadil LEPAJA



Referendumi i dështuar në Maqedoni, referendumi tjetër për tërheqjen e njohjes së shtetit të Kosovës nga ana e Malit të zi, i nisur përmes mbledhjes së 30 mijë nënshkrimeve, si dhe ideja për një referendum në Kosovë lidhur me korigjimin e kufijve me Serbinë, duket se e kanë burimin në të njëjtën konjunkturë, përkatësisht ide që të kthej mbrapsht, të e bllokojë ose se paku kushtëzojë procesin e integrimi euro-atlantike në Ballkanin perëndimorë.

Pas fushatës, agresive të dy presidentëve, atij serb dhe këtij kosovarë, për të korigjuar kufijtë, për të cilën vetëm ata mund të dinë se nga doli me të vërtetë, dhe e cila qysh e dimë hasi në kundërshtime të fuqishme sidomos në Kosovë, gati e tërë skena politike kosovare, doli të jetë kundër një propozimi të këtillë, përfshi këtu opozitën edhe pozitën. Pas refuzimit të kësaj ideje nga pjesa më e madhe e shteteve evropiane, në krye me Gjermaninë, dolën në sipërfaqe pyetje serioze, se agjendë e kujt mund të jetë kjo, në të vërtetë?

Ishte e çuditshme, sidomos kriza e fundit, e krijuar nga asgjë, me piknikun e presidentit kosovar në Ujman/Gazivodë, pa asnjë nevojë të dukshme politike, me personazhe kryesore dy personalitete të cilat kohëve të fundit kanë qenë (ar)miq për kokë. Edhe përkundër spekulimeve se prapa kësaj iniciative qëndrojnë SHBA, nuk u vërtetua me asnjë deklaratë zyrtare, dhe as me ndonjë përkrahje indirekte, se iniciativa Vuçiç-Thaçi, është agjendë euro-atlantike, nëse përjashtojmë këtu deklaratimet e nacionalistëve të njohur serb, dhe shpresat e tyre se SHBA po ndërton qëndrimin ndaj Kosovës dhe se kjo mund të jetë shenjë se SHBA qëndrojnë prapa saj.

Kështu, kur u shua zhurma e krijuar përmes medias së kontrolluar, dhe kur ra sadopak pluhuri i këtyre deklaratave, pas hutimit të parë, ka mbetur vetëm ideja e plasuar prej tyre se principet bazike të agjendës euro-atlantike në Ballkan, që janë mosprekja e kufijve dhe karakteri shumë etnik i shteteve, kanë dështuar dhe se për to Vuçiç dhe Thaçi e kanë një alternativë (të tyre ?).

Agjenda evropiane përmes insistimit në mosprekjen e kufijve të brendshëm të ish federatës jugosllave, ka bërë të pamundura agjendat e nacionalizmit serb për Serbi të madhe, por edhe pamundëson bashkimin e shqiptarëve në një shtet, edhe sikur shqiptarët të kishin fuqi tash të bënin një gjë të tillë, prandaj bashkimi i shqiptarëve, edhe popujve të tjerë, në agjendën euro-atlantike shihet i mundshëm veç në Evropën pa kufij. Mbi këtë bazë, projekti për korigjimin e kufijve mbi baza etnike, nxjerr brirët e një

marrëveshje, të fshehtë për definimin e kufirit në mes të dy popujve, atij serb dhe shqiptar në Ballkan, të sponsorizuar me shumë gjasë nga Moskva dhe Ankaraja, me çka do të hidhej baza e një baraspeshe të re në Ballkanin Perëndimor, me gjasë jashtë BE dhe jashtë NATO-s, dhe që llogaritet se do të përkrahej edhe nga disa vende të rëndësishme evropiane.

Agjenda evropiane, gjithashtu kërkon shtetin laik dhe përjashtimin e feve nga politika, që do të rrëzonte shtyllat kryesore të depërtimit dhe ndikimit rus dhe turk në regjion. Të pakënaqur me një Ballkan pa Rusinë dhe Turqinë do të ishin në Bosnjën dhe Hercegovinë, boshnjakët por edhe serbët. Edhe në Serbi, Maqedoni dhe Mal të zi, shumë janë ata që mendojnë se një Ballkan pa Rusinë do të ishte kundër interesave të tyre, ndërkohë që gjithnjë e më shumë edhe ndër shqiptarët ka mendime se Ballkani pa Turqinë është vështirë të paramendohet. Kjo mohohet nga kreu politik, i cili ka edhe interesa të ndërthurura ekonomike dhe financiare me të, por realiteti na shfaqet lakuriq te kutitë e votimit.

Bosna dhe Hercegovina, si objektivi kryesor rus edhe turk në Ballkan, shpërfaqë më së miri, edhe konfuzionin identitar, të popujve të Ballkanit, në rrethanat e

krijuara që karakterizohen me një politikë defanzive dhe plot dilema euro-atlantike kundrejt Ballkanit, me plotë kushte të cilat vështirë se do të plotësohen ndonjëherë në formën e kërkuar dhe në anën tjetër me ambicet neo imperiale, drejtë Ballkanit nga (ar)miqtë historik të popujve të këtij regjioni, të cilët tani po përfitojnë shumë nga ato, qoftë në planin ushtarak qoftë në atë ekonomik, pa telashet administrative dhe ligjore të BE.

Politika serbe në BeH, shpresat kryesore i ka në Moskën, dhe Putinin dorë fortë të saj. Edhe boshnjakët, pjesa muslimane e tyre, mbështetet në dorën e fortë të udhëheqësit turk Erdogan. Përderisa ambicet përkatësisht interesat ruse, për Ballkanin nuk janë fshehur asnjëherë, sidomos për korridorin e komunikimit drejt Adriatikut, i cili kalon nëpër Serbi dhe Mal të zi, korridorin drejt Selanikut, por gjithsesi edhe pjesën serbe të Bosnjës dhe Hercegovinës, ambicet e Turqisë në Ballkan kanë qenë më të mbuluara dhe vetëm nën dritën e marrëdhënieve të sforcuara me Rusinë, kanë marrë formën e pretendimeve të hapura, dhe të legjitimitit të interesave të veta sidomos ndër muslimanët, pra në Bosnje, Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë. E ashtu quajtura transversalja e gjelbër, ishte dhe mbeti ëndërr e neo-

osmanistëve në Ballkan. Koalicioni rusoturk në Siri, u tregua efektiv, dhe ata llogarisin se edhe në Ballkan mund të kenë rolin vendimtarë përballë Evropës heterogjene dhe SHBA të pa interesuar shumë për këtë zonë. Përjashtimi i Turqisë nga Evropa, me bllokimin e procesit euro integruar, dhe interesat e ndara rreth Lindjes së Afërme, kanë bërë që Ankaraja zyrtare të kërkojë partner tjetër, jashtë NATO-s dhe bashkë me Rusinë të shpalojë alternativën euro-aziatike për Ballkanin Perëndimor. A është ky vetëm kërcënim, për BE dhe perëndimin në përgjithësi, apo është projekt tashmë në realizim e sipër, mbetet të shihet muajt në vijim. Sido që të jetë, iniciativa për ndryshimin e kufijve, sikur pas një vetëtime që shkrepnin qiellit, shpërfaqë konturat e kësaj alternative, e cila do të detyronte edhe serbët, shqiptarët, boshnjakët dhe të tjerët në regjion të përcaktohen rreth modelit evropian apo atij evro-aziatik të organizimit të tyre shoqëror, politik e shtetërorë.

Kosova politike e la vetëm presidentin Thaçi, me agjendën euro-aziatike në dorë. Mbetet të shihet se cilat do të jenë pasojat e kësaj loje të re me gurët e kufirit? A ka ende ndokush dilema se kush dhe përse e kishte krijuar krizën rreth kufirit me Malin e zi, dikur?

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 4 tetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

MATILDA PËRBALL TRUMPIT, SHPËRTHEJNË KOMENTET NË TWITTER

Një statujë e një nga personazheve më të dashur të Roald Dahl, Matilda, është ngritur në shtëpinë e autorit. Heroina tani përballlet me një kundërshtar të ri dhe ai është Presidenti amerikan Donald Trump, i cili "fitoi" votën e lexuesve përpara kryeministres britanike Theresa May.

"Matilda tregon se është e mundur për këdo, sado i vogël dhe i pafuqishëm që të ndihen, për të mposhtur paragjykimet në jetën e tyre - një mesazh që ndjehet edhe më i rëndësishëm sot sesa 30 vjet më parë", shkruan Bernie Hall, nga kompania The Roald Dahl. Statujat, që shënojnë 30 vjetorin e karakterit të tij popullor, u ndërtuan përkohësisht jashtë Muzeut të Roald Dahl në Great Misenden Buckinghamshire, ku u bazua romani origjinal, edhe pse adaptimi i filmit popullor ndodhi në SHBA.

Matilda e Dahl është e famshme për



qëndrimin ndaj Drejtoreshës së qendrës së mjerimit dhe ngacmimit, Miss Trunchbull, në librin e vitit 1988. Trump u zgjodh si kundërshtari bashkëkohor për

Matildan, tani "30-vjeçare" nëpërmjet një sondazhi të lexuesve të kryer nga The Roald Dahl Story Company, duke fituar 42 për qind të votës popullore.

365 ditë të vitit me Putinin!



Si do të jetë viti që vjen? Vladimir Putin, pa bluzë teksa kalëron? Putin që pozon për një "selfie" me dy nuse? Apo Putin me një bebi leopard në krahë? Këtë vit, rusët kanë një varg zgjedhesh në kalendarin e sapopublikuar, ku shfaqet udhëheqësi rus. Disa të kënaqur, e të tjerë skeptikë... Një shitës në qendër të Moskës thotë se, kalendari është shumë i kërkuar, madje edhe nga turistët e huaj. Kalendari i vitit 2019, në fakt shihet kudo nëpër kancelaritë e Ruisë. Për çdo muaj, Putin vjen me një pozë të ndryshme, nga ato që në fakt janë parë edhe më herët. Në të shkuarën, gjithçka mbi të cilën shihej fotoja e Putinit ka qenë popullore në Rusi, por me një rënie të lehtë të mbështetjes dhe me protestat mbi moshën e daljes në pension, duhet pritur për t'u parë nëse ka ende oreks për 365 ditët e Putinit.

Vorombe, zogu më i madh në botë me 800 kg peshë

Vorombe është zogu më i madh që ka ekzistuar në tokë e qiell. Ai ka një lartësi prej 3 metrash dhe një peshë që arrin deri në 800 kg, çka e bënë që të pagëzohej nga komuniteti shkencor "Vorombe Titan", që në greqishten e lashtë do të thotë "Zog i Madh" dhe me të drejtë.

Vorombe është një lloj zogu elefant, por i paaftë për të fluturuar shpjegojnë studiuesit e Zoological Society Of London, të cilat pas shumë debatesh ndër vite, kryen një analizë tasonomike të qindra fragmenteve të kockave të gjetura të kësaj specijeje, që ruhen në muzeumet e mbarë botës. Me ndihmën e teknologjisë dhe metodave shkencore të avancuara u arrit në këtë konkluzion, i cili është publikuar në revistën shkencore prestigjioze britanike "Royal Society Open Science". Deri më sot shkencëtarët njëzëri konsideronin "Aepyornis Maximus" si zogun më të madh, i cili jetonte në Madagaskar në një epokë miliona vjeçare para nesh.



Por me zbulimin e fundit, paleontologët u bindën se zogu-elefant "Vorombe Titan" kalon të gjitha bindjet e deritani-

shme. Edhe ky habitatin e kishte në Madagaskar, të paktën deri në mbërritjen e njerëzve të parë aty.



Një film për jetën e Bud Spencer

Nga karriera e tij sportive e deri tek bota e artit, jeta e Carlo Pedersoli-t, i njohur ndryshe si Bud Spencer do të vijë tashmë në një film. Lajmin e ka dhënë djali i aktorit të humorit, Giuseppe Pedersoli gjatë festivalit "Terni Pop Film Fest" në Itali, ku ka thënë se është në hapat e para të punës. Mes të ftuarve të mbrëmjes përveç Giuseppe, ishte edhe vajza e Spencer, Diamante dhe nipi Alessandro Pedersoli, i cili tregoi jo vetëm disa episode interesante të karrierës së aktorit napolitan, por edhe faktin që Spencer nuk e quante asnjëherë veten aktor, pasi në filma ishte ashtu si në jetën e përditshme. Para se të bëhej një ikonë e kinematografisë, Spencer i dedikohet notit. Në vitin 1950 ishte i pari italian që bëri me not 100 metra në më pak se 1 minutë. Bud Spencer, e vendosi emrin e tij të artit i frymëzuar nga birra e tij e preferuar Budweiser si dhe nga aktori Spencer Tracy. Spencer ishte një figurë e pandashme nga Terence Hill, me të cilin ka realizuar pjesën më të madhe të filmave. Ai ndërroi jetë dy vjet më parë në qershor të vitit 2016 në moshën 87-vjeçare.

Lëngu i domates zvogëlon sulmin në zemër dhe kancerin e prostatës

Lëngu i domateve, ose siç e njohim në salca e domateve, është shumë e dobishme për organizmin e njeriut, kjo sepse përmban disa acide, të cilat janë të nevojshme për metabolizmin. Në zakonisht e marrim të gatshëm në supermarket, por ai që ka vlera të vërteta është lëngu i freskët i domateve. Kur ne e konsumojmë salcën e blerë nuk dinë se kur domatet konservohen dhe zihen, ato bëhen inorganike dhe të dëmshme për trupin tonë. Ndërsa lëngu i freskët i domates përmban shumë sodium, kalium, kalcium, magnez, vitamina A dhe të tjerë elementë të nevojshëm.

Ekspertët thonë se domatet përmbajnë veti ushqyese thelbësore që ndihmojnë në rigjenerimin e muskujve dhe uljen e presionit të gjakut. Domatet gjithashtu përmbajnë likopene, e cila ndihmon për të luftuar sëmundjet e zemrës dhe kancerin, duke zvogëluar mundësinë e sulmit në zemër dhe kancerit të prostatës.





Rrushi lufton tensionin e lartë të gjakut

Konsumi i rrushit çon në uljen e presionit të gjakut dhe përmirëson funksionin e zemrës. Shkencëtarët amerikanë kanë zbuluar këtë efekt në minjtë e laboratorëve që ushqehen me ushqime shumë të kripura. Doktor Mitchell Seymour nga Universiteti Miçigan, tha se ky zbulim konfirmon teorinë se rrushi ka ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e rrezikut të sëmundjeve të sistemit kardiovaskular. Në një studim të kryer nga Seymour dhe bashkëpunëtorët e tij, efekti i rrushit të zakonshëm në minjtë laboratorikë që vuanin nga tensioni i lartë, i shkaktuar nga marrja e ushqimeve shumë të kripura. Grupi i dytë i minjve mori ushqim shumë të kripur pa shtimin e rrushit. Pas 18 javësh, minjtë që hanin ushqime të kripura dhe rrush kishin presionin e ulët të gjakut, funksionin e mirë të zemrës, dhe më pak shenja të dëmtimit të muskujve të zemrës, në krahasim me minjtë që hanin ushqime të kripura pa ngrënë rrush. Seymour tha se ky është edhe një konfirmim tjetër se ushqimet e pasura me fruta dhe perime janë të dobishme për uljen e tensionit të gjakut.

PËR 6 VITE, 250 TË VDEKUR NGA FOTOT "SELFIE"



Agam Bansal thekson se, edhe pse thjesht veprimi i të bërit të një "selfie" nuk është vdekjeprurës në vetvete, rreziku shtohet kur njerëzit vendosin të përpjekje për të bërë foton perfekte

Herën tjetër që do t'iu shkojë në mendje të qëndroni buzë një shkëmbi panoramik, apo në majën e një ujëvare, kujdesuni mjaftueshëm për veten përpara se të bëni një "selfie", pasi mund të jetë edhe gjëja e fundit që bëni në jetë. Më shumë se 250 persona në mbarë botën kanë humbur jetën duke bërë "selfie" në 6 vitet e fundit, sipas një studimi të kryer nga "All India Institute of Medical Sciences", një grup kolegësh mjekësore publike me seli në Nju Delhi.

Gjetjet, që analizuan raportimet informative të të paktën 259 vdekjeve të lidhura me një "selfie" nga tetori i vitit 2011 deri në nëntor të vitit 2017, u publikuan në numrin e muajve korrik-gusht të "Journal

of Family Medicine and Primary Care". Nga 259 vdekjet, studiuesit zbuluan se shkak kryesor ishte mbytja, pas incidenteve ku përfshiheshin mjete transporti, - si shembull, bërja e një "selfie" përpara trenit që afrohet, apo rëniet nga lartësia. Shkaqe të tjera të vdekjeve të lidhura me "selfie"-t përfshijnë kafshët, armët e zjarrit apo rënia në korrent.

"Vdekjet pas një 'selfie' janë bërë një problem madhor i shëndetit publik", thotë Agam Bansal, autori kryesor i studimit për "Washington Post". Megjithatë studimi arriti në përfundimin se India kishte numrin më të lartë të vdekjeve se çdo vend tjetër në botë, raportime të shumta incidentesh fatale prej "selfie"-ve vijjnë gjithashtu nga Rusia, Shtetet e Bashkuara apo Pakistani.

Bansal thekson se, edhe pse thjesht veprimi i të bërit të një "selfie" nuk është vdekjeprurës në vetvete, rreziku shtohet kur njerëzit

vendosin të ndërmarrin rreziqe në përpjekje për të bërë foton perfekte.

"Nëse dikush qëndron në vend dhe përpjeket të bëjë një foto me një personazh të famshëm apo diçka tjetër, kjo nuk është e dëmshme, - tha ai. - Por, nëse 'selfie' është i shoqëruar me sjellje të rrezikshme, kjo është ajo që i bën 'selfie'-t të rrezikshme. Ajo që më shqetëson mua më shumë është shumica janë shkaqe të parandalueshme vdekjeje". Bansal shtoi se, shqetësim tjetër për të ishte fakti sesa shumë fatalitete të lidhura me "selfie"-t përfshijnë të rinjtë. Më shumë se 85 për qind e viktimave kanë qenë të grupmoshave 10-30 vjeç, shpjegon Bansal. "Këta formojnë të ardhmen e një kombi. Në atë moshë, shumë prej tyre nuk kanë arritur të kuptojnë se cilat janë objektivat e tyre, nuk dinë madje se çfarë duan të bëjnë apo të bëhen. Janë thjesht në lulëzimin e jetës së tyre".



Keni merak mos po ju mashtrojnë? Zbuloni me këtë test të thjeshtë nëse janë të skaduara!

Produktet ushqimore duhet të jenë gjithmonë në standardin e duhur në mënyrë që njerëzit të mos rrezikohen prej tyre. Ka shumë mënyra për të kontrolluar cilësinë e produkteve që hamë çdo ditë. Megjithatë, shumica e tyre kërkojnë ndihmën e profesionistëve ose pajisjeve speciale.

Por, në mënyrë që të shmangni një helmim apo problem tjetër shëndetësor të mundshëm, provoni këto teste të thjeshta për këto katër artikuj ushqimorë. - Mishi i pulës. Kushtojini vëmendje vizave të bardha dhe shtrësës së trashë të yndyrës në gjoksin e pulës. Nëse përmblajnë viza të tilla, u janë injektuar hormone për rritjen e shpendëve dhe pulat kanë fituar peshë shpejt. Një mish i tillë nuk është i shëndetshëm për shëndetin tuaj. Ngjyra po ashtu është shumë e rëndësishme sepse nëse është e verdhë, nuk është e freskët. Ata duhet të kenë një ngjyrë të trëndafilte dhe mish të butë.

- Mjalti. Mjafton të hidhni pak mjaltë në një sipërfaqe. Nëse mjalti derdhet shpejt përhapet menjëherë në sipërfaqe, atëherë nuk është cilësor. Në të kundërt, nëse ai është i trashë do të thotë që është në standardin e duhur. Nëse shijoni një ëmbëlsi të tepër, kjo do të thotë se ky mjaltë përmban sheqer të bardhë.

- Frutat dhe perimet e ngrira. Kontrolloni nëse një pako perime apo fruta të ngrira kanë copëza akulli në të. Nëse po, nuk është ruajtur siç duhet. Zgjidhni produktet që kanë akull mbi to. - Mishi. Kur zgjidhni mishin, shtypeni me gisht. Mishi i freskët duhet të jetë mjaft i qëndrueshëm për të zhdukur gjurmët e gishtave. Prijeni mishin përgjysmë: nëse mishi është i errët, por ka konturet e bardha, do të thotë se i janë injektuar hormone. Nëse kur e fshini me një pecetë nuk lë gjak apo lagështirë, atëherë është mish i freskët.

Tregoni fjalëkalimin e telefonit ose 5 mijë dollarë gjobë



"Udhëtarët do të detyrohen që të dorëzojnë fjalëkalimin e telefonit dhe laptopit të tyre tek oficerët zyrtarë që bëjnë kërkime digjitale", thuhet sipas ligjit të ri në Zelandën e re. Çdo njeri që do refuzon të dorëzojë informacionin personal do gjobitet me 5 mijë dollarë. Edhe më përpara lejohej që punëtorët e doganës të kërkonin pajisjet

digjitale, por jo fjalëkalimet. Njerëzit janë të zemëruar me këtë ndryshim dhe e konsiderojnë cenim të privatësisë. Ligji hyri në fuqi të hënën (1 shtator) që përcakton udhëzime të reja për oficerët që kryejnë kërkime digjitale. Në ligj thuhet se duhet të dorëzohen fjalëkalimet personale, kodet, pin si dhe shenjat e gishtërinjve.

Të lodhur nga gënjeshtria, fshati boshnjak u ndaloi fushatat politikanëve

Para zgjedhjeve të përgjithshme në BeH, fshati Podgora i parajmëroi të gjithë kandidatët e të gjitha partive të mos shkojnë atje. "Na gënjeni me vite. Asnjë aptri nuk është e mirëseardhur në Podgorë", shkruan në një transparent të madh që ndodhet në mes të fshatit. Në anën e pasme të transparentit, për ata të cilët janë këmbëngulës, është shkruar porosia: A e lexuat? Njerë-

zit thonë: Mjaft më". Disa nga aktivistët partiakë menduan se banorët e fshatit nuk emdojnë seriozisht, por pllakatet e tyre ishin shqyer. Podgora ka 700 banorë dhe ka pak gjasa që në zgjedhjet e së dielës do të dalin të votojnë. Më pak se 20 për qind e qytetarëve kanë besim tek politikanët në shtet, ceket në anketën e Shoqatës së gazetarëve të BeH-së.



LAJMET
 ВЕСТИ НА АЛБАНСКОМ ЈЕЗЫКУ

Serbia rikthen edicionin e lajmeve në gjuhën shqipe


Radio Televizioni i Serbisë ka filluar transmetimin e lajmeve në gjuhën shqipe. Ky është një rikthim i këtij formati pas disa vitesh ndërprerje. Programi informativ quhet "Lajmet", ndërsa transmetohet nga ora 19:00 dhe përveç nëntitujve, është në gjuhën shqipe. Dita e parë e lajmeve në gjuhën shqipe filloi me një raport mbi vizitën e presidentit serb Aleksander Vuçiç në Rusi, ku u bisedua edhe rreth Kosovës. Edicioni i parë i lajmeve në gjuhën shqipe po ashtu përfshinte një lajm rreth kryetarit të kuvendit Kadri Veseli, referendumin e dështuar në Maqedoni, cunamin në Indonezi dhe në fund parashikimi i motit. Cili është qëllimi i transmetimit të lajmeve në gjuhën shqipe nuk shpjegohet në mënyrë specifike. Megjithatë, kjo gjë është kritikuar mjaft shumë mediat serbe, shkruan Indeksonline.



Hiqet gatishmëria ushtarake në kufi me Kosovën

Presidenti serb dhe komandant suprem i Ushtrisë së Serbisë, Aleksandar Vuçiç dje herët në mëngjes e tërhoqi urdhrin për gatishmëri të rritur ushtarake të forcave për reagim urgjent dhe të shpejtë. "Presidenti i Serbisë dhe komandant suprem i Armatës së Serbisë, Aleksandar Vuçiç herët në mëngjes, në pajtueshmëri të autorizimeve të tij të caktuara me Ligjin për mbrojtje, ministrit të Mbrojtjes Aleksandar Vulin dhe shefit të Shtatmadhorisë së Ushtrisë së Serbisë Millan Mojsilović, u dërgoi urdhrin për tërheqjen e gatishmërisë së rritur ushtarake të forcave për reagim urgjent dhe të shpejtë", njoftoi Ministria e Mbrojtjes. Ushtria e Serbisë në bashkëpunim me strukturat e tjera të sigurisë, në pajtueshmëri të urdhrin të komandantit suprem, edhe më tej e ndjek situatën e sigurisë dhe është e gatshme në çdo moment ta mbrojë shtetin dhe të gjithë qytetarët, pa dallim se ku jetojnë", njofton Ministria resore.

PËRPLASJA E MADHE



Edhe pse Haradinaj është shprehur haptazi kundër kësaj ideje, presidenti Hashim Thaçi ka lobuar për një marrëveshje Kosovë-Serbi që përfshin korrigjimin e kufijve. Këtë ide, prestigjiozja amerikane 'The New York Times' e ka përshkruar si "spastrim etnik paqësor"

Revista amerikane 'Newsweek', i ka dedikuar një shkrim përplasjes ndërmjet kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe presidentit Hashim Thaçi për idenë e korrigjimit dhe ndryshimit të kufijve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

'Newsweek' shkruan se Haradinaj, në vizitën e tij në SHBA, lo-

boi kundër idesë së prezantuar nga Hashim Thaçi për korrigjimin të kufijve. "Unë kam qenë pjesë e luftërave dhe tragjedi, kështu që nuk dua që fëmijët e mi të përjetojnë diçka që unë e kam përjetuar 20 vite më parë", u shpreh kryeministri i Kosovës në një intervistë për 'Newsweek'.

Edhe pse Haradinaj është shprehur haptazi kundër kësaj ideje, presidenti Hashim Thaçi ka lobuar për një marrëveshje Kosovë-Serbi që përfshin korrigjimin e kufijve. Këtë ide, prestigjiozja amerikane 'The New York Times' e ka përshkruar si "spastrim etnik paqësor". Por, kjo ide e Hashim Thaçit është kundërshtuar ashpër edhe në arenën ndërkombëtare. Kryeministri Haradinaj u shpreh për 'Newsweek' se një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë është e nevojshme, por thotë se çështja e kufijve asnjëherë nuk duhet të vihet në diskutim.

"Ne kemi nevojë për një marrëveshje ligjërish të detyrue-

shme me Serbinë, edhe pas një të kaluarë tragjike. Por, territori dhe kufijtë asnjëherë nuk dihet të vihen në diskutim", u shpreh Haradinaj. Sipas kryeministrit të Kosovës, zbatimi i një ideje të tillë do të shkakonte një tragjedi të re. "Është një rrugë shumë e shkurtër që dërgon në tragjedi", u shpreh Haradinaj. Sipas tij, kushdo që e përkrah këtë ide nuk e respektonte Republikën e Kosovës dhe çka është arritur.

"Një ide e tillë është një kërcënim për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit", shtoi Haradinaj. Revista amerikane në shkrimin e saj përmend edhe protestën e organizuar me 29 shtator nga Lëvizja Vetëvendosje, gjithashtu edhe sondazhin përmes të cilit rreth 75 % e të anketuarve janë shprehur kundër idesë së shkëmbimit të territoreve. Edhe pse shumica e kundërshton idenë e korrigjimit të kufijve, ka njerëz që e mbështesin propozimin e Thaçit.

"Gjëja më e keqe është qën-

drimi në status-quo. Edhe pse marrëveshja për korrigjimin të kufijve duket e rrezikshme, duhet pasur parasysh se qëndrimi në status-quo është një gjë e tmerrshme dhe është një ftesë e hapur për ndërhyrje të jashtme, incidente dhe konflikte", u shpreh Petrit Selimi për 'Newsweek'.

Sipas Selimit, Hashim Thaçi është njëri prej politikanëve më të besuar në Kosovë. Por, analistët thonë që shumë kosovarë nuk i besojnë Thaçit për arritjen e marrëveshjes me Serbinë.

"Opinionin publik është konfuz pasi shumë gjëra janë ende mister. Së pari ka mosbesim të plotë për Hashim Thaçin dhe motivet e tij personale për të hyrë në këto bisedime", u shpreh analisti Agon Maliqi për 'Newsweek'. "Perceptimi i publikut në Kosovë është gjithashtu i hutuar nga ndarja midis partnerëve perëndimorë, veçanërisht nga hezitimi gjerman dhe britanik për të përfaqëuar idenë e shkëmbimit të territoreve", përfundon Maliqi.

Vizat mund të mos hiqen deri në fund të 2019-ës

Skenari më pozitiv është që vendimi për liberalizimin e vizave për Kosovën të merret gjatë këtij viti, megjithatë nuk përjashtohet mundësia që ky proces të shtyhet deri në fund të vitit 2019.

Liberalizimi i vizave për Kosovën rrezikon të mos ndodhë deri në pjesën e dytë të vitit 2019, megjithëse pritjet janë që vendimi të merret brenda këtij viti.

Ditë më parë presidenti Hashim Thaçi ka thënë se liberalizimi mund të mos ndodhë deri në vitin 2020 nëse pushteti dhe opozita nuk argumentojnë para vendeve të Bashkimit Evropian se janë plotësuar kriteret për liberalizim. Megjithatë opozitarët dhe njohësit e integritimeve evropiane



thonë se tani vendimi për heqjen e vizave varet nga vullneti i shteteve anëtare të BE-së, ndërsa nuk e përjashtojnë mundësinë që heqja e regjimit të vizave për kosovarët të mos ndodhë deri pas zgjedhjeve për Parlamentin Evropian, respektivisht deri në fund të vitit 2019.

Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë për gazetën "Zëri" se opozita në Kosovë luan një rol të rëndësishëm në proceset integruese,

megjithatë në takimin me Grupin COWEB deputetët e Vetëvendosjes kanë qenë destruktivë duke mos i pranuar të arriturat e Kosovës.

"Opozita duhet të jetë konstruktive sidomos kur bëhet fjalë për interesin e qytetarit. Askush nuk mund të lirohet nga përgjegjësia që ka, deputetët e opozitës janë votuar dhe përfaqësojnë qytetarët e vendit. Fatkeqësisht deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje kanë qenë destruktivë në takimin e fundit me COWEB-in duke mos i njohur reformat e bëra, gjë që mund të ndikojë negativisht në procesin e liberalizimit të vizave", ka deklaruar Hoxha.

LUFTË SPIUNËSH, BRITANIA AKUZON RUSINË PËR SULME KIBERNETIKE

Agjencia e Inteligjencës Ushtarake të Rusisë (GRU) ka agjentë në gjithë globin dhe përgjigjet drejtpërdrejt te shefi i shtabit të përgjithshëm dhe ministri rus i Mbrojtjes. GRU nuk komenton publikisht për veprimet e veta. Struktura, numri i stafit dhe financimi i saj janë sekrete shtetërore ruse

Britania akuzoi inteligjencën ushtarake ruse për një mori sulmesh kibernetike, me qëllim dëmtimin e institucioneve të rëndësishme perëndimore.

Një raport për sigurinë kombëtare të Britanisë konstatoi se Agjencia e Inteligjencës Ushtarake të Rusisë (GRU) është "agresore shkatërruese kibernetike", që përdor një rrjet hakerësh për të përhapur mosmarrveshje dhe konfuzion në gjithë botën.

GRU, thuhet në raport, qëndron me siguri pas sulmit me softuerin "BadRabbit", vitin e kaluar, ndaj një aeroporti ndërkombëtar të Ukrainës, si dhe pas piraterimit të Agjencisë Botërore Anti-Doping në Zvicër.

Raporti i Qeverisë britanike po ashtu konstatoi se GRU qëndron pas piraterimit të emaileve të Komitetit Kombëtar të Partisë



Demokrate në SHBA, që dëmtuan kandidaten për presidente të SHBA-së, Hillary Clinton. Kjo e fundit u mund nga republikani Donald Trump, në zgjedhjet e vitit 2016.

"Veprimet e agjencisë GRU janë të pamatura: ato përpiqen të minojnë dhe të ndërhyjnë në zgjedhje, duke sulmuar në mënyrë të qartë demokracinë perëndimore", tha sekretari i Jashtëm britanik, Jeremy Hunt.

"Mesazhi ynë është i qartë: së bashku me aleatët tanë, do t'i ekspozojmë dhe do t'i përgjigjemi përpjekjeve të GRU-së për të minuar stabilitetin ndërkombëtar", tha ai.

Raporti britanik tha se GRU është e lidhur me një mori hakerësh të përfshirë në sulme të profilit të lartë dhe të njohur me emra të tillë si APT 28, Fancy

Bear, Sofacy, Storm pengu, Sednit, CyberCaliphate, CyberBerkut, Voodoo Bear dhe BlackEnergy Actors. "Ky model i sjelljes tregon dëshirën e tyre për të vepruar pa marrë parasysh ligjin ndërkombëtar ose normat e vendosura dhe me ndjenjën e mosndëshkimit", tha Hunt.

Shtetet e Bashkuara tashmë e kanë akuzuar GRU-në për sulme kibernetike para zgjedhjeve presidenciale të vitit 2016 dhe kanë sanksionuar zyrtarë të saj - përfshirë shefin Igor Korobov - për veprimet e tyre të dyshuara.

Thesari i Shteteve të Bashkuara ka thënë në muajin mars se GRU "me vetëdije angazhohet në aktivitete që dëmtojnë sigurinë kibernetike, në emër të Qeverisë ruse".

Edhe pse më pak e njohur se KGB-ja - agjencia e spiunazhit e

Bashkimit Sovjetik - GRU ka luajtur rol të madh në disa nga ngjarjet më të mëdha gjatë shekullit të kaluar, nga kriza e raketave kubane në vitet 1960 deri në aneksimin e gadishullit ukrainas të Krimesë, në vitin 2014.

GRU ka agjentë në gjithë globin dhe përgjigjet drejtpërdrejt te shefi i shtabit të përgjithshëm dhe ministri rus i Mbrojtjes. GRU nuk komenton publikisht për veprimet e veta. Struktura, numri i stafit dhe financimi i saj janë sekrete shtetërore ruse.

Kryeministrja britanike, Theresa May, ka thënë se oficerët e GRU-së qëndrojnë pas përpjekjes për të vrarë ish-agjentin rus, Sergei Skripal, dhe vajzën e tij me një agjent nervor në qytetin anglez Sallsbëri, në muajin mars. Rusia i ka mohuar akuzat.

Hungaria dhe Ukraina thellojnë krizën diplomatike

Ukraina ka shpallur konsullin hungarez "persona non grata" (të padëshiruar) duke i kërkuar të largohet nga shteti brenda 72 orëve. Ministria e Jashtme hungreze ka akuzuar më 4 tetor diplomatit për "aktivitete që nuk përkojnë me statusin e zyrtarit të konsullatës".

Ky vendim ka ardhur pasi Kievi ka akuzuar Konsullatën Hungareze për lëshim të pasaportave në mënyrë të paligjshme për hungarezët në Ukrainë. Në përgjigje të vendimit të Ukrainës, ministri i Jashtëm hungarez, Peter Szijjarto, ka thënë në një konferencë për media se shteti i tij dëbon konsullin ukrainas në Budapest. Szijjarto po ashtu ka përsëritur kërcënimin për bllokim të anëtarësimit të Ukrainës në NATO dhe Bashkimin Evropian. Ndërkohë ministria e Jashtme e Ukrainës ka shfaqur shpresën e pala hungareze "do të qëndrojë larg hapave armiqësorë kundër Ukrainës në të ardhmen dhe se zyrtarët e tij nuk do të shkelin legjitimitetin e Ukrainës". Aty po ashtu është thënë se Kievi konsideron banorët e Ukrainës që kanë origjinë hungareze si "faktor bashkues" në marrëdhëniet mes të dyja shteteve dhe i ka bërë thirrje Hungarisë "të bëjë të njëjtën gjë". Besohet se në rajonin ukrainas, Zakarattya, jetojnë rreth 200,000 persona me etni hungareze. Ky dëbim ka shtuar tensionet në mes të marrëdhënieve Ukrainë-Hungari. Të dyja vendet janë përplatur me njëra-tjetrën pasi publikimit të një videoje muajin e kaluar në të cilin shihen disa persona me orgjinë hungareze duke marrë pasaporta të Hungarisë në konsullatën në Berehove të Ukrainës.

TURQIA, EKSPORTUESJA MË E MADHE E LAJTHIVE NË BOTË

Rreth 75 për qind e furnizimit botëror merr udhë në Turqi dhe një e treta e kësaj sasive vjen nga kodrat e gjelbra të Ordusë. Provinca mbështetet te të korrat për 80 për qind të aktivitetit të saj ekonomik



Shifrat treguan se Bashkimi Europian ishte tregu më i lartë në shtator. Eksportet në BE përbëjnë 77 për qind të eksporteve turke të lajthive. Muajin e kaluar, eksportet e lajthive të përpunuara me vlerë 69.4 milionë dollarë - arrinin në 48.6 për qind të eksporteve totale të Turqisë, ndërsa pjesa tjetër ishin lajthitë e papërpunuara.

Turqia, e cila është eksportuesi më i madh në botë i lajthive, fitoi 1,78 miliardë dollarë me gati

287,000 ton eksport të lajthive nga shtatori 2017 deri në fund të gushtit 2018.

Për të gjithë ata që adhurojnë lajthitë, një qytet i vogël në Detin e Zi në Anadollin lindor, është një kopsht fantastik që i prodhon ato me shumicë.

Banorët i çojnë të rinjtë në shkollë që kanë emrin e familjeve më të mëdha të prodhimit të lajthive. Studentët shkojnë në universitetin më të afërt për të stu-

diuar për lajthitë e në kohën e lirë, ata ulen në hapësirat publike ose në parqe që kanë emrin e të tjerë banorëve të lajthive.

Rreth 75 për qind e furnizimit botëror merr udhë në Turqi dhe një e treta e kësaj sasive vjen nga kodrat e gjelbra të Ordusë. Provinca mbështetet te të korrat për 80 për qind të aktivitetit të saj ekonomik. "Nëse nuk do të kishte lajthi në Turqi, çmimi do të ishte rritur 5-fish", thotë Irfan Balkanlıoğlu, guvernatori vendas.

Mënyra sesi një rajon i vogël disa orë larg kufirit me Gjeorgjinë, ia doli të jetë në hartën ushqimore të tregut botëror të lajthive, është disi e paqartë edhe për vetë vendasit. Disa ia atribuojnë mrekullisë ku bie shi pa ndërprerë, temperaturave të ndryshueshme, stepës, terrenit të thyer që e bëjnë zonën të papërshtatshme për produkte të tjera.

Të tjerë thonë se autoritetet dikur morën në dorë mbjelljen e pemëve të lajthive për të parandaluar rrëshqitjen e dheut. Por çfarë është e dukshme tani, është se Ordu mburret me cilësinë e produktit final.

Ndërsa çmimet arritën rekordin, vendet fqinje të Turqisë, si Gjeorgjia dhe Azerbajxhani, filluan të zgjerojnë plantacionet e tyre të lajthive. Po ashtu, edhe shtete në Amerikën e Jugut dhe në SHBA, kanë filluar të bëjnë përpjekje për të shtuar prodhimin. Por edhe banorët e Ordusë kërkojnë të reduktojnë mbështetjen e ekonomisë së tyre mbi lajthitë. Ata presin që të korrat të jenë edhe më të ulëta, për shkak të ndryshimit klimatik. Megjithatë, edhe për një kohë të pacaktuar, Ordu do ta ruajë pozicionin e vet të rëndësishëm në prodhimin botëror të lajthive.

Koha, e premte, 5 tetor 2018



Vrau burrin pas abuzimeve që pësonte, ekzekutohet "nusja-fëmijë"

Nuk gjetën përgjigje thirrjet për lirin e "nuses-fëmijë" e dënuar për vrasjen e burrit të saj, kur ishte ende e mitur. Zeinab Sekaanvand, 24-vjeçarja nga Irani, e dënuar me vdekje, u ekzekutua këtë të martë.

Rasti i saj u denoncua nga 'Amnesty International' duke thënë, "Jo vetëm Zeinab ishte e mitur në momentin e krimit, por procesi gjyqësor ndaj saj ishte i parregullt. Kishte marrë asistencë ligjore vetëm në fazën finale të procesit, në vitin 2014, kur kishte tërhequr dëshminë dhe pasi agjentët e kishin rrahur".

Ngjarja daton në vitin 2011, pasi Zeinab u detyrua të martohet me të shoqin në moshën 15-vjeçare. Gjatë martesës ajo u dhunua dhe abuzua, duke vendosur që të bëjë vetë drejtësi. Kur u arrestua në moshën 17-vjeçare pak kohë pas krimit, ajo rrëfeu gjithë abuzimet e pësuar, madje akuzoi edhe vëllanë e të shoqit se e mishte përdhunuar. Dënimi me vdekje u shty për të, pasi në burg e reja në vitin 2016 ishte rimartuar me një të dënuar dhe kishte mbetur shtatzënë, por e lindi fëmijën të vdekur. Sipas mjekëve vdekja erdhi për shkak të shokut të pësuar, pasi i ekzekutuan shoqen e qelisë, shkruan koha.mk.

Bazuar në ligjin iranian, të miturve iu shtyhet dënimi me vdekje nëse në momentin e krimit nuk ishin në gjendje të kuptonin natyrën e krimit të tyre. Nga një ekspertizë psikiatrike, rezultoi se Zeinab ishte e prekur nga një formë e rëndë depresioni e shoqëruar me pagjumësi dhe vështirësi për të marrë vendime.



Wazir, 27 vjeçe, i ka fituar më 11 shtator zgjedhjet paraprake të Partisë Demokratike për ulëse në legjislaturën e shtetit dhe nëse mund kundërshtarin republikan, Dennis Soucy, në zgjedhjet për Kongres, që do të mbahen në nëntor, ajo do të bëhet ish-refugjatja e parë që mban post publik në Nju Hempshir



REFUGJATJA AFGANE QË MUND TË BËJË HISTORI NË SHBA

"Jeto i lirë ose vdis" është motoja zyrtare e shtetit amerikan Nju Hempshir. Ajo përshtatet mirë me Safiya Wazir, një refugjate afgane, e cila ka ikur nga sundimi taliban në vitet 1990. Ajo fillimisht është vendosur në Uzbekistan me familjen e saj dhe tani është një shtetase amerikane që mund të bëjë histori politike në Nju Hempshir. Wazir, 27 vjeçe, i ka fituar më 11 shtator zgjedhjet paraprake të Partisë Demokratike për ulëse në legjislaturën e shtetit dhe nëse mund kundërshtarin republikan, Dennis Soucy, në zgjedhjet për Kongres, që do të mbahen në nëntor, ajo do të bëhet ish-refugjatja e parë që mban post publik në Nju Hempshir.

"Shumë njerëz sakrifikojnë për liri", tha Wazir në një bisedë telefonike me Radion Evropa e Lirë. "Unë e kisha mundësinë të jetoj lirshëm ose të vdes", tha ajo. Wazir është vendosur në Shtetet e Bashkuara në vitin 2007. Ajo është diplomuar në shkollë të mesme dhe është bërë shtetase e SHBA-së në vitin 2013. Pas tre vjetësh punë me pagë të ulët, ka fituar diplomë biznesi.

Tani, ajo po bën fushatë për të përfaqësuar Qarkun 17, një lagje në Konkord, kryeqytetin e Nju Hempshirit, ku mbizotërojnë të bardhët. Në zgjedhjet paraprake të Partisë Demokratike, Wazir ka mundur Dick Patten, 66 vjeç, ish-këshilltar i qytetit. Gjatë fushatës, Patten thuhet se i ka akuzuar emigrantët për "marrjen e gjithçkaje", siç janë përfitimet sociale, në kurriz të njerëzve të lindur dhe të rritur në Nju Hempshir. Pas humbjes, ai është cituar të ketë thënë: "Ajo është nga Afganistani, kështu që është trajtuar si princeshë". Patten raportohet të ketë thënë se ai do të votojë për rivalin republikan të Wazirit në zgjedhjet e nëntorit. Wazir është befasuar me fitoren e saj.

"Larmia e popullsisë në komunitet po rritet", tha ajo. "Unë dua të jem zëri i të gjithëve, nga të lindurit këtu deri te emigrantët. Dua të jem një shembull për brezin e ri. Ju e keni mundësinë, me lirinë dhe demokracinë që kemi, për t'u ngritur dhe për të bërë më mirë", tha Wazir. Wazir ka kaluar vite e përfshirë në aktivizmin e komunitetit dhe i është përkushtuar edukimit dhe çështjeve familjare.

Nëna e dy fëmijëve - që pret fëmijën e saj të tretë në janar - ka bërë fushatë për një kujdes të zgjeruar shëndetësor dhe për leje të paguar prindërore, ndërsa ka luftuar për më shumë fonde për

shkollimin e fëmijëve. Wazir është pjesë e valës së të rinjve dhe pakicave që kanë arritur sukses në zgjedhjet paraprake në SHBA, duke i mposhtur rivalët e vjetër. Kjo, sipas vëzhguesve, sinjalizon dëshirën e shumë votuesve demokratë për ndryshime.

Në mesin e tyre është edhe Stacey Abrams, një 44-vjeçare me ngjyrë, e cila është e emëruara e demokratëve për guvernatorë të shtetit të Xhorxhias. "Është më në fund viti që gratë të ngrihen dhe të kandidojnë", tha Wazir. E lindur në rrethin Dushi të provincës Baghlan, në Afganistanin verior, familja e saj është zhvendosur në Uzbeki-



stanin fqinj më 1997, kur ajo ishte gjashtë vjeçe. Dhjetë vjet më vonë, Wazir është shpërngulur në Konkord me prindërit e saj, me ndihmën e Fondit për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara (UNICEF). Edhe pse mban në mend pak për Afganistanin dhe atje është kthyer vetëm një herë - në vitin 2012, për t'u martuar - vendi i saj i lindjes mbetet një burim frymëzimi. Fokusi i saj, megjithatë, është në shtëpinë e saj të adoptuar.

"Afganistani është përballur me shumë vështirësi. Por, kjo nuk ndodh vetëm në Afganistan, sepse kemi situata të tilla edhe në SHBA dhe kemi shumë probleme në Nju Hempshir, prandaj garoj", tha Wazir.



NUMËR REKORD I GRAVE GAROJNË NË ZGJEDHJE

Një numër rekord i grave po konkurrojnë për zyra publike në Shtetet e Bashkuara, duke i bërë zgjedhjet e ardhshme shtetërore dhe kombëtare edhe më të rëndësishme sesa normalisht. Më 6 nëntor do të mbahen zgjedhjet për 435 ulëset e Dhomës së Përfaqësuesve dhe 35 të Senatit, ashtu si edhe zgjedhjet për guvernatorë në 33 shtete dhe për legjislatura në shumicën e shteteve. Vetëm për Kongres, numri i grave kandidatë i kalon dukshëm vitet e kaluara, thotë Qendra për Gratë dhe Politikën Amerikane në kuadër të Universitetit Rutgers, në Nju Xhersi. Për Dhomën e Përfaqësuesve garojnë 239 gra, ndërsa për Senatin 23. Këto shifra nuk i përfshijnë edhe gratë që kanë garuar në zgjedhjet paraprake këtë vit, në të cilat votuesit i zgjedhin kandidatët për të përfaqësuar një parti

politike ose tjetër, zakonisht atë Demokratike ose Republikane. Në të dyja këto parti të mëdha ka pasur rritje të numrit të grave kandidatë, por në Partinë Demokratike rritja ka qenë më e madhe: më shumë gra garojnë tani si kandidatë demokratë sesa të gjitha gratë që kanë kandiduar në zgjedhjet e vitit 2014, nga të dyja partitë. "Është vit i thyerjes së rekordeve, nuk ka dyshim", thotë Jean Sinzdek, nga Qendra për Gratë dhe Politikën Amerikane. Në mesin e 46 shteteve që mbajnë zgjedhje për legjislaturat në nëntor, 3381 kandidatë janë gra, shumë më lart se rekordi i mëparshëm prej 2649, i vendosur në vitin 2016. Ashtu si në rastin e Kongresit, shumica dërrmuese e kandidatëve janë demokratë. Entuziazmi midis grave reflektohet në mënyra të ndryshme në garat politike, thotë Sinzdek.

KUPA E MAQEDONISË

SHKËNDIJA KALON NË ÇEREKFINALE



"Përkundër epërsisë nga ndeshja e parë në këtu erdhëm të luajmë sikur rezultati të ishte 0:0. Shënuam golin e parë shumë herët dhe më pas menaxhuam si duhet lojën për fitore bindëse 5:0", deklaroi pas ndeshjes sulmuesi i ri Shefit Shefiti

Koha

Fisnik NUHIU

Shkup, 4 tetor - Shkëndija avansoi në mënyrë bindëse në çerekfinale të Kupës së Maqedonisë pasi fitores 2:0 ndaj ekipit Kit Go në ndeshjen e parë në Tetovë sot i shtoi triumf 5:0 në Pehçevë. Shefit Shefiti me tre gola ishte figura qendrore e takimit, shënoi edhe Mici, ndërsa golin e tij të parë në fanellën kuqezi e gjeti sulmuesi Samir Fazli. Trajneri Osmani ndeshjen e nisi me formacion të kombinuar, ndërsa duke llogaritur fitoren 2:0 në ndeshjen e parë historia e këtij dueli të 1/8 së finale morri fund që në minutën e dytë kur Shefiti realizoi për 0:1. Në

vazhdim Mici dyfishoi rezultatin ndërsa golin debutues me Shkëndijën e gjeti Samir Fazli në minutën e 28. Në fraksionin e dytë kuqezinjët menaxhuan lojën dhe shtuan edhe dy gola tjerë me Shefitin (68' dhe 90') për fitore bindëse 5:0. Shkëndija avansoi në çerekfinale të Kupës pasi eliminoi ekipin e Ligës së Dytë, Kit Go me rezultat të përgjithshëm 7:0, ndërsa pas fitores së sotme 5:0 kanë folur protagonistët Shefit Shefiti dhe Samir Fazli. I pari realizoi tre golëshin e parë me ekipin senior të kuqezinjëve, ndërsa i dyti gjeti golin debutes me Shkëndijën në ndeshjen e tij të dytë. "Përkundër epërsisë nga ndeshja e

parë në këtu erdhëm të luajmë sikur rezultati të ishte 0:0. Shënuam golin e parë shumë herët dhe më pas menaxhuam si duhet lojën për fitore bindëse 5:0", deklaroi pas ndeshjes sulmuesi i ri Shefit Shefiti i cili në vazhdim foli për tregolëshin e tij. "Kam shënuar shumë gola me ekipet e moshave, por realisht është ndjehje e bukur që munda të realizoj hat trik me ekipin e parë. Ky do të jetë motiv për të vazhduar të punoj edhe më shumë në të ardhmen", përfundoi Shefiti. I kënaqur që gjeti golin e parë si kuqezi shprehet edhe sulmuesi Samir Fazli. "Jam i lumtur që arrita të shënoj, pasi në sulmuesit këtë detyrë kemi.

Kishim përballë një ekip modest, por luajtëm me përkushtim dhe me meritë avansojmë në raundin e ardhshëm", deklaroi Samir Fazli. Në takimet tjera të luajtura në Kupën e Maqedonisë u arritën këto rezultate: Ka qenë befasuese humbja e liderit të tabelës Vardari, të cilën në terren mysafirë u mposhtën nga Makedonija GJ.P me rezultatin 2:1 dhe janë eliminuar nga Kupa pasi në ndeshjen e parë ka barazuar 1:1. Me rezultatin e përgjithshëm 3:2 Makedonija GJ.P vazhdon garat më tej. Akademija Pandev edhe pse ka pësuar humbje 0:1 në terren vendas nga Bregallnica kanë kaluar mëtej pasi në ndeshjen e parë shënuan fitore të thellë me rezultat 6:2. Belasica pas fitoren në ndeshjen e parë si mysafirë me rezultatin 2:0, edhe në ndeshjen kthyesë ka shënuar fitore përballë Pelisterit me rezultatin 3:1 dhe kështu me rezultatin e përgjithshëm 5:1 ka kaluar mëtej. Më tej ka vazhduar edhe Rabotnički duke eliminuar Tikveshin. "Romantikët", në ndeshjen e parë fituan 1:0, ndërsa në ndeshjen e dytë barazuan 1:1. Ekipi i Gostivarit nuk ka arritur të kalon në fazën tjetër pas dy humbjeve nga Pobeda, të parën 2:1 dhe në ndeshjen e dytë pësuan disfatë me rezultatin 4:1. Sileksi me dy fitore ndaj Skopjes ka kaluar në raundin tjetër. Në ndeshjen e parë shënuan fitore me rezultat 2:0 ndërsa në përballjen e dytë po ashtu arritën fitore me rezultatin 2:1.



Rikthimi i trishtë i Naser Alijit në Zvicër

Naser Aliji prej muajsh stërvitet me ekipin e ligës së tretë zvicerane, FC Baden. Ky është ekipi i parë në karrierën e Alijit. Është qyteti, ku Aliji është rritur dhe familja e tij jeton akoma. Por, përse Naser Aliji vendosi të rikthehej aty? Arsyeja është e trishtë dhe këtë Naseri e shpjegoi në një intervistë për "Blick.ch". "Pasi më mbaroi kontrata me Virtus Entella kisha disa oferta, por vendosa të rikthehem te FC Baden për të qëndruar pranë familjes. Babai im u diagnostikua me kancer dhe vendosa që këto muajt e fundit të jetës së tij t'i qëndroj pranë. Babai, fatkeqësisht ndërroi jetë para 4 ditësh", u shpreh Aliji. Shkrimi i "Blick": Dhjetë vjet më parë, Naser Aliji kaloi nga ekipi i Aargau te të rinjtë e FC Basel. Ai arriti bashkë me Brel Embolo në ekipin e parë, pasi u konsiderua lojtar mjaft premtues, edhe më i madh se sulmuesi aktual i Schalke 04, i cili ishte disa herë kampion dhe tani luan në Champions League. Futbollisti i kombëtares shqiptare u transferua në klubin gjerman të Kaiserslautern dhe më vonë në Itali, në divizionin e tretë, te Virtus Entella. Naseri Aliji është kthyer në shtëpi që nga vera. Për një arsye të trishtuar: babai i tij ishte i sëmurë rëndë, me kancer. Ai vdiq të dielën e kaluar. "Çdo gjë në jetë e ka një qëllim", thotë Aliji. "Në verë nuk isha i zhgënjyer vetëm se nuk kisha një klub. Papritmas, kuptova se duhet të kaloja kohë me babain tim. Ai ishte në muajt e tij të fundit të jetës". Për shkak të situatës familjare të krijuar, Aliji nuk pranoi asnjë kontratë në Itali, në verë, pavarësisht interesimit të disa klubeve. Për disa javë, mbrojtësi i majtë u stërvit te FC Baden, për të ruajtur një formë të arsyeshme sportive. Qëllimi i tij është një kontratë në Super League, ose e një klub ambicioz në "Challenge League".

ISH FUTBOLLISTI I GALLATASARAJIT MERR DREJTIMIN E ÇAIRASVE

Umut Karan, trajner i ri i Shkupit

Shkup, 4 tetor - Skuadra e FC Shkupi të enjten e ka prezantuar trajnerin e ri, ndërsa ky post i ka takuar legjendës së futbollit turk dhe evropian, Umut Karan, i cili vitet më të suksesshme të karrierës së tij i ka kaluar me ekipin e Gallatasarajit dhe me kombëtaren turke.

Në konferencë për shtyp të enjten është prezantuar edhe drejtori gjeneral i ekipit, Tufan Dash, i cili vjen si zëvendësues i Shefqet Demirit. Njëkohësisht gjatë kësaj konference u prezantua edhe trajneri kondicional Volkan Sajellgan.

Para mediave në cilësinë e trajnerit të FC Shkupit foli edhe Umut Karan, i cili mes tjerash se Maqedoninë e njeh nga e kaluara e tij si futbollistë.

"Ju dëshiroj mirëseardhje, mirëpo edhe për mua është mirëseardhje për vetveten. Në Maqedoni kam ardhur në të kaluarën me përfaqësuesen e Turqisë. Gjasat janë të mëdha që në këtë shtet të gjejmë talente të mëdha. Prej Ballkanit kanë dalë shumë talente të mëdha. Një prej arsyeve që jemi këtu është ky fakt. Duam që këta



futbollist t'i ngrisim në yje të mëdha të futbollit. Momentalisht FC Shkupi është poshtë në tabelë, për këtë arsye jemi këtu që klubi të shkojë më lartë. Puna jonë është që të nxjerrim futbollist për përfaqësuesen e Maqedonisë dhe Shqipërisë. Mirëpo në të njëjtën kohë edhe klubi do të duhet të jetë në nivel. Nëse nuk arrihet kjo nuk bëhet asgjë", tha mes tjerash Ka-

ran. Drejtori gjeneral i skuadrës, Tufan Das nuk ka folur shumë, por ka potencuar se në këtë klub ka njerëz të cilët e duan Shkupin dhe punojnë pa kursyer asgjë për ta bërë më të mirën.

"Gjithçka që bëhet e mirë te Shkupi ka tre "fajtor", janë Omer Bunjaku, Ertan Demiri dhe Suat Alija. Nga Turqia kemi ardhur për një projekt të madh të FC Shkupi

dhe të jemi sponsor kryesor i kësaj skuadre. I falenderoj të gjithë ata që ishin para nesh, ne kemi ardhur që të krijojmë të ardhmen e klubit", ka thënë Tufan Das.

Skuadra e Shkupit të enjten pasdite e pati stërvitjen e parë nën urdhrat e trajnerit të ri Umut Karan, i cili pritet të debutojë në duelin e të shtunës ndaj Rabotniçkit, që luhet stadiumin e Çairit.

FEDERATAT MË TË FUQISHME EKONOMIKISHT, FA E PAKONKURRUESHME



Federata e Anglisë është në krye të botës nga pikëpamja ekonomike, ndër federatat që morën pjesë në Kampionatin Botëror të Futbollit, "Rusi 2018". Ashtu si Premier League, Football Association ka treguar vitet e fundit se është e aftë të gjenerojë fitime më të larta

Anglia është në krye të botës, të paktën nga pikëpamja ekonomike, ndër federatat që morën pjesë në Kampionatin Botëror të Futbollit, "Rusi 2018". Ashtu si Premier League, Football Association ka treguar vitet e fundit se është e aftë të gjenerojë fitime më të larta. Në vitin financiar 2016/17, të ardhurat e Football Association, ishin rreth 400 milionë euro (351 milionë paundë), duke e mbyllur bilancin me fitim 18,5 milionë

euro (16,3 milionë paundë). Kjo falë të drejtave televizive (150 milionë euro), pasi Football Association menaxhon jo vetëm të drejtat televizive të Kombëtares së Anglisë, por edhe të FA Cup dhe Superkupës angleze (FA Community Shield). I njëjti diskutim vlen edhe për Gjermaninë, që mban vendin e dytë. Në vitin financiar 2016 (i fundit i disponueshëm), të ardhurat e Deutscher Fußball-Bund (DFB) ishin 290 milionë

euro, ndërsa fitimi 7,8 milionë. Kombëtarja e Gjermanisë ka kontribuar me 85 milionë euro, ndërsa DFB Pokal (Kupa e Gjermanisë) me 63 milionë euro të tjera. Në vend të tretë, është Franca. Gjatë vitit financiar 2016/17 Fédération Française de Football ka marrë kontribute nga UEFA. Por pjesa më e madhe e të ardhurave, 238 milionë euro (fitimi 812 mijë euro) vjen nga sponsorët (87 milionë) dhe të drejtat televizive (52 mi-

lionë). Në vend të katërt, Spanja. Të ardhurat e Real Federación Española de Fútbol (RFEF) nuk kanë shkuar më shumë se 136 milionë euro, 43,5 milionë euro nga të drejtat televizive. Të ardhurat e RFEF janë pak më të larta se ato të Federatës së Futbollit të Brazilit (Confederação Brasileira de Futebol), 128 milionë euro, nga të cilat 83 milionë nga sponsorët, me Nike që kryeson. Top 10 plotësohet me Portugalinë (Federação

Portuguesa de Futebol, 65,9 milionë të ardhura në 2016/17); Zvicrën (Association Suisse de Football, 54 milionë të ardhura në 2016), Belgjikën (Koninklijke Belgische Voetbalbond, 54 milionë të ardhura në vitin 2017), Argjentinën (Asociación del Fútbol Argentino, 51 milionë të ardhura në vitin 2017, të cilat parashikohen të rriten në 75 milionë euro në 2018) dhe Kroacinë (27 milionë euro në 2017).

'Pogba do të ishte më i miri në botë nën menaxhimin e Fergusonit'



Paul Pogba do të ishte lojtari më i mirë në botë nën menaxhimin e Sir Alex Fergusonit, sipas Michael Owen, i cili nuk është duke kaluar në formë të mirë nën urdhërat e Jose Mourinhos. Mesfushori francez nuk po arrin ta gjejë formën e ti të mëparshme, dhe është përfolur disa herë për një largim nga "Old Trafford". "Mendoj se ai është një superlojtar, edhe pse po

ndihem keq kur po e shoh duke luajtur tani", ka thënë ish-sulmuesi i Liverpoolit dhe Manchester Unitedit. "Nën menaxhimin e Fergusonit ai do të ishte më i miri në botë. Ai e nxirrte më të mirën nga lojtarët dhe e vërente talentin e tyre. Kemi shembullin konkret të Eric Cantonas". Oweni po ashtu foli edhe për formën e Alexis Sanchezit. "Kam thënë edhe më parë, San-

chezi do të ishte më i mirë nëse do të transferohej te Manchester City. Jam shumë i bindur që trajnerët kanë ndikim të madh".

Konferenca e tretë e shtypit mes Wilder dhe Fury degjeneron në sherr

Konferenca e tretë për shtyp që kanë zhvilluar sot boksierët Deontay Wilder dhe Tyson Fury ka degjeneruar në një sherr masiv, në momentin që dy boksierët shkuan "face to face", duke shtyrë njëri-tjetrit. Madje për një moment u duk se raundi i parë i këtij dueli do të zhvillohej në skenë, por ndërhyne personat e sigurisë dhe stafet përkatëse për të evituar grushtet. Wilder dhe Fury, pas dy konferencave të zhvilluara në Londër dhe Nju Jork, u takuan sërisht në Los Anxhelos, aty ku më 1 dhjetor do të zhvillojnë duelin e vlefshëm për titullin kam-

pion bote të peshës së rëndë, që mbahet nga boksieri amerikan (kategoria WBC). Në një moment, ashtu si në dy daljet e para publike, boksierët ishin të lirë dhe shkuan ballë për ballë njëri-tjetrit. Në këtë moment ata shtyhen dhe ndërhyne organizatorët për të ndaluar që boksierët të kapen me grushte. Por situata degjeneroi në sharje e fyerje të rënda, duke krijuar kaos në skenë dhe për pak sa boksierët nuk kaluan në përplasje fizike. Kjo situatë zgjati për më shumë se 2 minuta, duke bërë që konferenca për shtyp të përfundonte para kohe.

Publicitet



Po mahnit në Serinë A, Piatek në orbitën e Barcelonës

Është sensacioni i momentit jo vetëm në Serinë A. Ka shënuar 8 gola në 6 takimet e para të Serisë A dhe vlera e tij në merkato është shumëfishuar. Referenca është për sulmuesin e Genoas, Krzysztof Piatek, që është shndërruar në objektivi i skuadrave të mëdha, ku përfshihet edhe Barcelona. Sigurisht që është herët për të folur për një transferim të mundshëm të 23-vjeçarit në "Camp Nou", por sikurse njoftojnë mediat pranë

"blaugranave", drejtuesit e klubit katalan po e vëzhgojnë me shumë interes ecurinë e polakut. Presidenti Preziosi shpenzoi vetëm 4 milionë euro gjatë merkatos së verës, për ta marrë nga Cracovia, ndërsa çmimi i tij pas vetëm 6 takimesh në Serinë A është 10-fishuar. Ndoshta edhe më shumë, sepse me këtë ritëm që po shënon polaku, klubet e mëdha nuk do të hezitonin për të shpenzuar shifra të mëdha.



Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/2005, 106/2008, 61/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16) nenit 3 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 120/18), Pëlqimit të MASH nr. 12-10292/4 të datës 19.09.2018 dhe vendimit të drejtorit për publikim të shpalljes nr. 03-692 të 03.10.2018, SHFK "Bratstvo" – Shkup me seli në rr. "Moskovska" nr. 18, publikon

SHPLLJE PUBLIKE

Për plotësimin e vendit të lirë të punës mësimdhënës të mësimit klasor për mësimin në gjuhën shqipe – financim i ri për vitin shkollor 2018/2019

Dy mësimdhënës të mësimit klasor për mësimin në gjuhën shqipe me fond javor të mësimt prej 20 orë mësimore për kohë të caktuar më së voni deri më 10.07.2019.

Java e punës zgjatë pesë ditë pune edhe atë: ndërimi i parë prej ora 08,00 deri në ora 12,00 dhe ndërimi i dytë prej ora 12,00 deri në ora 16,00.

Neto pagesa fillestare është 21.500,00 den.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me nenin 77 dhe nenin 80 të Ligjit për arsim fillor.

Së bashku me fletëparaqitjet kandidatët duhet të parashtrihen: diplomë për arsimin e mbaruar përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter dhe certifikatë e shtetësisë.

Fletëparaqitjet parashtrihen deri në SHFK "Bratstvo" – Shkup në rr. "Moskovska" nr. 18 personalisht ose përmes postës.

Shpallja zgjatë tri ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej dhjetë ditëve nga dita e kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Për kandidatët të cilët aplikojnë për plotësimin vendin e lartpërmendur të punës më 15.10.2018 (e premte) me fillim në ora 10.30 do të organizohet testim për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik dhe gjuhës shqipe dhe alfabetit të saj.

Personi për kontakt – sekretari, tel. 3077-889

SHFK "Bratstvo" – Shkup Drejtor

Në bazë të nenit 23 të Ligji për marrëdhënie pune –Teksti i pastruar (Gazeta zyrtare 167/15), Shkolla fillore "Vrapçisht" Vrapçishtë shpall

SHPLLJE PUBLIKE

Për krijimin e një marrëdhënie pune

1. Një defektolog me orar të plotë pune në kohë te pacaktuar Kushtet:

Sipas kushteve të përgjithshme të Ligjit për Arsim fillor Bashkë me lutjen kandidati duhet ti dorëzoj edhe këto dokumente Dokument për shkollim, vërtetim mjekësor, vërtetim nga gjykata se nuk është nën hetim dhe nuk udhëhiqet procedurë penale, vërtetim për shtetësi, certifikata e lindjes, karton personal, kopje të letërnjoftimit.

Lutje së bashku me dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri te shkolla. Shpallja zgjatë 5(pesë) ditë pune, nga dita e publikimit.

Nr. 0401-38/16
05.10.2018 viti

Shkolla fillore "Vrapçisht" Vrapçisht

“Shënuam në kohën e duhur. Nëse Mertens do të kishte shënuar disa minuta më parë, do të kishim vuajtur për më shumë kohë. Do të thotë shumë për ne, sepse kemi fituar kundër finalistëve të edicionit të kaluar të Ligës së Kampionëve”, ka deklaruar Ancelotti

Carlo Ancelotti tha se ishte i kënaqur me fitoren e fundit të Napolit në Ligën e Kampionëve, ndaj Liverpool. Lorenzo Insigne ishte heroi në Napoli, sepse shënoi golin e vetëm të sfidës së të mërkurës, në minutën e 90. Ancelotti ishte i gëzuar nga fitorja trepikëshe, por veçanërisht i kënaqur me mënyrën e triumfit të tijve ndaj gjigantëve të Premier League dhe finalistëve të Championsit të kaluar. “Ekipi bëri mirë gjatë gjithë lojës, kurrë nuk e kemi humbur kontrollin. Ishim gjithmonë shumë të fokusuar, mbi të gjitha kur mbronim, dhe nuk i lejuam Liverpoolit praktikisht asgjë”, tha Ancelotti për “Sky Italia”. “Ne patëm shanset për të shënuar më herët, por mendoj se kemi vepruar mirë edhe në sulm. Shënuam në kohën e duhur. Nëse Mertens do të kishte shënuar disa minuta më parë, do të kishim vuajtur për më shumë kohë. Do të thotë shumë për ne, sepse kemi fituar kundër finalistëve të edicionit të kaluar të Ligës së Kampionëve. Kjo është e rëndësishme për besimin e lojtarëve. Këto lojërë të japin fokus të veçantë, por edhe disa shqetësime. Unë u thashë lojtarëve të mi vetëm të kënaqen me veten dhe gjithçka shkoi mirë. Ne kemi treguar se ky grup nuk do të jetë i vështirë për Napolin, por për të gjithë. Pas zhgënjimit në ndeshjen e parë, kjo është një injeksion i madh besimi, por ka ende rrugë të gjatë për të përshkuar në këtë grup”, ka deklaruar Ancelotti. Jurgen Klopp e ka pranuar se humbja e Liverpoolit nga Napoli mbrëmë ka qenë e merituar dhe se ata nuk ishin mjaftueshëm të mirë sipas trajnerit gjerman. “Humbja është e merituar, nuk kemi pse ta bëjmë histori. Kishim momentet tona, mirëpo formacioni nuk ishte i duhuri disa herë. Lëvizëm në hapësirat e gabuara”, ka thënë Klopp pas ndeshjes. Ne duhet të qëndrojmë të qetë në situata të tilla. Sonte nuk ishim mjaftueshëm të mirë. Duhet ta fajësojmë veten për këtë. Në Grupin C, Napoli është në vendin e parë me 4 pikë, pastaj Paris Saint-Germaini dhe Liverpooli me nga 3 pikë, në fund është Crvena Zvezda me 1 pikë. Trajneri i Interi, Luciano Spalletti ishte i kënaqur me ekipin e tij ndaj PSV Eindhoven, teksa pati lëndë për kapitenin Mauro Icardi dhe mesfushorin Radja Nainggolan. Nerazzurët u rikthyen edhe një herë në Ligën e Kampionëve, për të luftuar përsëri dhe për të fituar 2-1 në Eindhoven falë golave të Naing-

LIGA E KAMPIONËVE

FITORE NË “FRYMËN E FUNDIT”, KJO I SHIJOI MË TEPËR ANCELOTTIT



golan e Icardi, dhe kjo e ka bërë të lumtur trajnerin Spalletti. “Nëse ju i jepni hapësirë PSV-së, ata janë një skuadër e fortë me lojtarë të cilët janë të shkëlqyer në ajër, kështu që ne u përpoqëm të zgjedhim momentin e duhur për t’i shtypur ata”, ka thënë fillimisht Spalletti për Sky Sport Italia. “Ne bëmë mjaft mirë. Duhet të komplimentojmë Radja Nainggolan, pasi ai u kthye në nivellet e tij të vjetra sonte. Ai kishte lëndim nga para-sezoni dhe kjo me të vërtetë e ngadalësoi përparimin e tij. Mund të kemi luajtur disa topa më mirë sesa të vazhdonim të kthehem prapa. Ka pasur momente ku nuk kemi bërë maksimumin e mundësive për të ecur përpara. Duke thënë këtë, u përpoqëm ta mbanim ndeshjen më larg golit tonë dhe të shmangnim shumë kundërsulme, sepse Hirving Lozano është i shkëlqyer në këtë drejtim. Mauro ka disa karakteristika të sakta. Ai nuk ka dobësi në përfundimin, ai është i përsosur. Ndonjëherë, si në pjesën e dytë, ai duhet të fokusohet më shumë në rikthim dhe ndihmë ndaj mesfushës, ashtu siç bëri në fund të ndeshjes. Kur ai dëshiron, di se si të duket më i fortë dhe më i fortë sesa ai është në të vërtetë. Ai duhet ta bëjë këtë më shpesh. Plus, sigurisht, ai është një kafshë në zonë”, përfundoi trajneri italian. Ernesto Valverde ka thënë pas ndeshjes se

BROZOVIC: INTER BESOI NË FITORE

Marcelo Brozovic ka thënë se “ata vazhduan që të besojnë dhe kjo është arsyeja pse fituan ndeshjen e dytë me radhë kundër PSV Eindhoven. Ashtu sikurse kundër Tottenham, Nerazzurri u rikthyen përsëri nga një gol disavantazh për të fituar ndeshjen e dytë kundër PSV me rezultat identik, 2-1. “Ne stërvitemi mirë, bëjmë gjithçka për të fituar dhe ne e dimë që fitorja është i vetmi option”, tha Brozovic për Sky Sport Italia. “Madje edhe kur ne ishim në disavantazh, vazhduam që të besojmë, kuptuam që nëse koncentrohemi më shumë do ta dalim të lumtur nga ky stadium. Ne të gjithë jemi të përkushtuar, ne luftojmë për njëri tjetrin dhe kjo tregohet në fushë. Ne do të vazhdojmë kështu. Një mesfushorë me në thëllësi, gjithmonë me ka pëlqyer kjo pozitë dhe jam i lumtur, ka deklaruar Brozovic.

Barcelona e tij gjithmonë përpiqet të dominojë takimet, pas fitores së tyre 4-2 ndaj Tottenham Hotspur në Ligën e Kampionëve. Gjiganti katalunas ka marrë një fitore të madhe në udhëtimin e tyre në Wembley dhe kjo fitore e ka bërë të lumtur trajnerin spanjoll të Barcelonës. “Loja ishte shumë intensive, ne prisim që të ishte kështu, por doli edhe më shumë sesa që menduam”, ka thënë fillimisht Valverde pas ndeshjes. “Që nga fillimi kemi vënë veten përpara, por ata treguan karakter në lojë. Ne dominuam, luanim nga prapa dhe patëm një performancë e mirë. Patëm shanse të rrisim epërsinë tonë në pjesën e dytë. Ata u kthyen me dy gola, por, për fat të mirë, e bëmë 2-4. Ne patëm shanse të mjaftueshme që të mos vuajmë aq shumë, por në fund të fundit ju gjithmonë vuani

në Ligën e Kampionëve. Jemi ekip që gjithmonë përpiqet të dominojë dhe të marrë iniciativën. Ekipi luan gjithmonë kështu, por ndonjëherë rezultatet na shoqërojnë ose na kthejnë shpinën. Trajneri spanjoll pati lëndë edhe për lojtarët e tij si Lionel Messi, Philippe Coutinho dhe Arthur, të cilët ishin ndër kryesoret në fitoren e Barçës.

MESSI: LIGA E KAMPIONËVE ËSHTË SPECIALE

Nuk ka dyshim se Barcelona është duke e konsideruar si prioritet Ligën e Kampionëve në këtë stinor dhe këtë e ka thënë edhe Lionel Messi, Messi ka qenë i pandalshëm në fitoren e katalonasve kundër Tottenhamit me rezultatin 4-2 në Wembley, ku Messi ishte protagonist pas shënimit të dy golave. “Liga e Kampionëve

është kremi mbi tortë për të gjithë”, tha ylli argjentinas pas ndeshjes. Por për të mbërritur në atë pjesë duhet të bësh mirë edhe në ligë dhe në kupë, duhet të paraqitesh mirë në ligë për t’u paraqitur mirë pastaj në Ligën e Kampionëve. Nuk do ta lëmë anash asnjë kompeticion, Liga e Kampionëve është speciale por ne do të luftojmë për ligën dhe kupën. Asnjëherë nuk është e lehtë të luash si mysafir në Ligën e Kampionëve e aq më pak të luash kundër një skuadre si Tottenhami”, ka deklaruar Messi. Barcelona dhe Interi janë në krye të tabelës me nga 6 pikë, kurse Tottenhami dhe PSV-ja janë me 0 pikë.

LOPETEGUI, TRAJNERI ME REZULTATET MË TË KËQJIA NË EPOKËN E PEREZIT

Me tri humbje në dhjetë ndeshjet e para të këtij sezoni të ri, Julen Lopetegui e ka bërë fillimin më të keq të një stinori nga të gjitha trajnerët e Real Madridit gjatë kohës kur presidenti i klubit ka qenë Florentino Perez. Real Madridi i kanë fituar vetëm pesë ndeshje deri më tani në këtë sezon, duke barazuar dy herë në La Liga, kundër Athletic Bilbaos dhe Atletico Madridit.

Ata, në po të njëjtën garë, janë mposhtur me rezultat 3-0 nga Sevilla. Rezultat në fillimin e sezonit të ri të ish-trajnerit të Kombëtares së Spanjës janë më të këqija edhe se ato të Rafa Benitezit, i cili ishte shkarkuar në janar edhe pse kishte qenë i pamposhtur në dhjetë ndeshjet e para në këtë pozitë. Këto janë rezultatet e dhjetë ndeshjeve të para në të gjitha sezonet gjatë kohës kur Florentino Perez ka qenë president i klubit madrilen. Me ngjyrë të gjelbër janë shënuar fitoret, më të hirtë barazimet, ndërsa me të kuqe humbjet. Ish-trajneri John Toshack e mbante rekordin për rezultatet më të këqija në fillim të sezonit para Lopeteguit, me vetëm katër fitore, por e kishte vetëm një humbje në këto dhjetë ndeshje.

ANTOINE GRIEZMANN HYN NË HISTORI, SHËNOI GOLIN E 8000-TË NË LIGËN E KAMPIONËVE

Antoine Griezmann krijoi një pjesë të vogël të historisë së Ligës së Kampionëve, të mërkurën, pasi shënoi golin e 8000-të të këtij kompeticioni, duke luajtur për Atletico Madrid. Sulmuesi i Francës ka një vit për t’u kujtuar gjatë, sepse doli me Atletico Madrid në vendin e dytë të La Liga-s, fitoi Ligën e Europës dhe Superkupën e Europës, pa harruar triumfin me kombëtaren e tij në Botërorin e Rusisë. Dhe, pasi të besuarit e Diego Simeone vuajtën në ndeshjen hapëse të grupit të Ligës së Kampionëve për këtë sezon, ata u rikthyen

në më të mirën e tyre të mërkurën, duke mundur Club Brugge 3-1. Si zakonisht, Griezmann ishte mes shënuesve të golave, duke realizuar në minutën e 28-të dhe barazuar epërsinë e hershme të belgëve. Ky gol, për më tepër, ishte i 8000-ti në historinë e Ligës së Kampionëve. Kampioni i botës shënoi edhe golin e dytë për të tjetër, në minutën e 67-të. Griezmann, pra, hyn në një grup të shquar lojtarësh, të cilët kanë shënuar golat jubilarë që nga emërtimi i këtij kompeticioni si Liga e Kampionëve, në vitin 1992. Ish-sulmuesi i

Evertonit dhe Nigerisë, Daniel Amokachi, ishte njeriu i parë, që do të shënonte në këtë garë. Përfaqësuesit e tjerë të rëndësishëm përfshijnë David Trezeguet, i cili shënoi golin e 3000-të në fitoren 7-0 të Juventusit kundër Olympicos, dhe Peter Crouch, shënuesi i golit të 4000-të si lojtar i Liverpool, kur mundi PSV Eindhoven me rezultatin 1-0, në prill 2007. Goli i 7000-të në Champions ishte shënuar nga Angel Di Maria për PSG, në nëntor 2015, pasi gjigandët e Ligue 1 shkatërruan Malmo, me rezultatin 5-0.

Koha, e premte, 5 tetor 2018



DASHI 21. mars - 20. prill

Do të jeni shumë të organizuar dhe strategjik dhe kjo gjë do ju lejojë që të zgjidhni brenda një kohe të shkurtër të gjithë ato probleme të cilat nuk ju kanë lejuar të arrini një objektiv të përcaktuar. Horoskopi i 4 tetorit, ju fton që në dashuri të jeni më të përkushtuar.



DEMI 21. prill - 21. maj

Kjo ditë do të jetë mjaft konfuze dhe do ju bëjë tejet nervoz, ndaj për këtë arsye është më mirë që të ruani një profil të ulët në punë. Këshillohet që në çështjet e familjes të ruani qetësinë.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Parashikohet një ditë mjaft e favorshme për të zyrtarizuar një raport. Këshillohet që të ndiqni instinktin në vendin e punës, pasi intuita juaj e shkëlqyer do ju çojë drejt suksesit.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Kjo ditë do të jetë mjaft paqësore dhe relaksuese, megjithatë nuk do të jeni plotësisht të kompletuar. Kjo e enjte do të sjellë mundësi të shumta për të planifikuar me detaje gjithë ato projekte që keni nisur prej kohësh.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Do të jeni të fortë, karizmatikë dhe të motivuar. Megjithatë kur bëhet fjalë për ndjenjat, prireni që të mbylleni në veten tuaj. Keni frikë të gaboni, të lëndoheni, por kjo situatë mund të rezultojë e rrezikshme. Një histori e bukur mund të lindë, por duhet të gjeni kurajën të bëni përpara.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Duhet të jeni më të matur lidhur me situatën tuaj ekonomike, pasi ky është momenti që nuk përjashton të papritura të vogla, me të cilat do të përballeni. Kjo është një periudhë shumë e mirë për të rinovuar një marrëveshje apo për të eksperimentuar në vendin e punës.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Kjo është periudha gjatë së cilës do të jeni më të fortë dhe do të rezultoni fitues, sidomos nga pikëpamja profesionale, ku mund të merrni më shumë përgjegjësi. Duhet të jeni gati të përfshihen në aventura të reja romantike, pasi sharmi juaj do të jetë maksimal.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Parashikohen ditë të cilat ju shohin mjaft të angazhuar, por mos u druani pasi ky është momenti më i mirë për tu rikthyer në lojë dhe për të çuar përpara propozime të reja në vendin e punës. Në dashuri ka disa zgjedhje që duhet të bëni, të cilat do ju lejojnë që të përkufizoni totalisht një raport.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Parashikohet një javë e cila do ju lejojë që të merrni lajme të mëdha dhe konfirmime të rëndësishme në vendin e punës. Megjithatë së fundmi mund të provokoni shumë partnerin/en, çka mund të krijojë disa keqkuptime.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Tashmë që po arrini një objektiv ambicioz, do të rigjeni sigurinë në vete dhe kapacitetet tuaja, shkruan noa.al. Duhet të jeni të gatshëm për tu hapur më shumë në raportin në çift, pasi në mbrëmje parashikohen takime mjaft të favorshme.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Duhet të sforcoheni dhe të kontrolloni impulset tuaja, sidomos nëse në vendin e punës po përballeni me disa çështje mjaft delikate dhe të rëndësishme për karrierën tuaj. Horoskopi i kësaj dite këshillon që të jeni të kujdesshëm dhe të bëni kujdes në familje.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Do të keni një intuitë të mprehtë, e cila do ju lejojë që ta shfrytëzoni në avantazhin tuaj dhe kjo gjë do ju lejojë që të merrni rezultate mjaft të favorshme në vendin e punës. Përfitoni nga koha e lirë, për ta kaluar me personat që i keni përzemër. Orët e mbrëmjes do ju gjejnë më të qetë dhe të relaksuar.

Mensur Mamuti	VEPRIMTARI DHE LETRARI NË FOTO, DELVINA	POSTI MË I LARTË I POLITIKANIT NË FOTO	ZAKONET	SUREJA E 35-TË E KURANIT FUTBOLLISTI GJERMAN, OZIL	F
VARFËRIA, SKAMJA (BISED.)					
PJESËTARET E NJË KOMBIASIATIK PASHTET					
K					
KRUSHQARI, LAJMËSI					
E ETSHME					
QËNDISJET, OJAT					
O					PËRVOJA
LEGJENDË				RUMANIA FILOZOFI FRËNG, DEKART	
PARAFJALË GJERMANE		RUTENIUMI NËNA E ISAUT			
AUTORI KOSOVAR, BALILI					
AUTORI NORVEGJEZ, HENRIK					



NË KETË DATE

5 TETOR 1871
1 GUSHT 1932

I					KOHA	MËNDAFSH (SH.)	URANI	FUTBOLLISTI SPANJOLL, HOZE LUIS	NJËSIA PËR REZISTENCË ELEKTRIKE
QYTETI FRANCEZ, SENT ...					MUNDJE JAPONEZE				
GAZI QË E THITHIM					SULLTANI QË E PUSHTOI KONSTANTINOPOLIN				
A				FIS NË TANZANI QYTETI NË KONGRESIN E TË CILIT PËRS. NË FOTO EMEROHET KRJETAR			OSMAN MULA KËNGËYTARJA, ISTREPI		
KOHA	RELACIONI (SHKURT.) PËRKULJA, LAKIMI			LËNG PANGJYRË (PARFUMERI, MJEKËSI)					
ENERGJIA		PORTIERI URUGUAJAN, FERNANDO KËNGËYTARJA AMERIKANE, DAJANA		SHENJA E NDALIMIT					PJESË E TRUPIT
BANOR I KRUEQYTETIT TË KOSOVËS									
MOHIM LODHËSE, E MUNDIMSHME		FËMËJË I VOGËL, FOSHNIË, KERTHI KALIUMI					NJË PASTHIRRMË ZANORJA E TRETË		
RR									

ZGJIDHJET: F, SKAMA, KURDET, LVESI, E ETUR, OJMET, MIT, R, AN, RU, NIMET, IBSENI, ETJEN,
SUMO, AJËR, ASA, OM, REL, ETERI, F, MUSLERA, PRISHTINALI, JO, NJOME, E, J, RRASKAPITËSE.

Shumë i lehtë **Sudoku** *mesatar*

9		1			4		6	8	3				9				
	7						3	1					5				
	3		6	8			2		2			7		3			
6	2		9	7	3					6	1		2		5		
				2				3							8		
			3	4		6		5	2								
	4			5		3		1			7		9				
	6							4						8		2	7
3												2		4			1

Shumë i lehtë: 981235476, 276194835, 435678129, 624957381, 857321694, 193486752,
742563918, 568719243, 319842567. Mesatar: 837261954, 169435278, 425879361,
796182435, 354697182, 218354796, 571926843, 943518627, 682743519.

Çfarë po ndodh me shqiptarët? 26 divorce në 100 martesë!

Sipas statistikave të Gjykatës së Tiranës, në harkun kohor të 9 muajve janë depozituar në total 1671 padi për zgjidhje martesë. Koha e shqyrtuar është nga 1 janari deri më 2 tetor 2018. Ndër to, 461 janë të përfunduara. Pjesa tjetër, më shumë se 70 për qind e çështjeve të ardhurave këtë vit për zgjidhje martesë janë ende në shqyrtim. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, paditë për zgjidhje martesë në nëntë muajt e 2017 ishin 1563, ndër të cilat 447 çështje të zgjidhura. Ka një rritje të numrit të kërkesave për divorc me rreth 7 për qind. Edhe paditë për pension ushqimor janë në total 26, ndër të cilat vetëm 8 çështje janë përfunduar. Si-



pas specialistëve, kjo ndodh në rastet kur bashkëshorti - pjesë e procesit të divorcit, mohon dhënien e pagesës mujore së detyruar për fëmijën ose caktohet nga vetë gjykata pagesa minimale e parashikuar. Dy nga katër nëna të divorcuara nuk marrin pagesën e plotë të mbështetjes së fëmijës. Disa të tjera detyrohen të braktisin punën që kanë pasur më parë, në kushtet e kërkimit të një pune të përshtatshme edhe me oraret e fëmijëve. Në kategorinë e çështjeve gjyqësore që i përkasin çështjeve familjare, janë më rritje numri i lëshimit të urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes, në total për 9 muajt kanë arritur 725 të tilla, ndër të cilat vetëm 27 janë çështje të përfunduara. Vitin e shkruar numri total i tyre ishte 570, ekzekutimi i të cilave ishte më pak se 20. INSTAT raportoi që në 2016-n kishte rreth 5500 divorce, niveli rekord ky i historisë së pastranzicionit, me gati 25 divorce për çdo 100 martesë. Të larta kishin qenë ndarjet edhe në 2015-n, me 21 divorce për 100 martesë.

shtjeve familjare, janë më rritje numri i lëshimit të urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes, në total për 9 muajt kanë arritur 725 të tilla, ndër të cilat vetëm 27 janë çështje të përfunduara. Vitin e shkruar numri total i tyre ishte 570, ekzekutimi i të cilave ishte më pak se 20. INSTAT raportoi që në 2016-n kishte rreth 5500 divorce, niveli rekord ky i historisë së pastranzicionit, me gati 25 divorce për çdo 100 martesë. Të larta kishin qenë ndarjet edhe në 2015-n, me 21 divorce për 100 martesë.

Vetura e Marilyn Monroe në shitje për 500.000 dollarë



Vetura e Marilyn Monroe është nxjerr në ankand. Pas restaurimit makina është kthyer në gjendje për të lëvizur, dhe tashmë çdokush mund të bëhet pronari i saj. Vetura është e tipit Ford dhe është prodhuar në vitin 1955. Poashtu është përdorur edhe në dasmën e saj një vit më vonë. Monroe është fotografuar duke i dhënë makinës me bashkëshortin e saj dramaturgun Arthur Miller, menjëherë pas martesës së tyre në qershor 1956, shkruan mapo.al. Darren Julien, president i Auctions Julien, tha se "Vetura ishte jo vetëm pjesë e historisë së automobilave, por vjen me një atmosferë magjepsëse, romancë dhe tragjedi të një legjende të vërtetë të Hollywood". Në ankand ajo shitet për një çmim marramendës prej 500.000 dollarë. E veçanta e kësaj makine janë targat "MM" që i posedon.

"PARAJA SHKON TEK PARAJA".

Zvicerani fitoi loton evropiane 160 milionë euro

Për herë të dytë këtë vit, një fatlum nga Zvicra fiton në lotarinë evropiane "Euro Millions". Këtë herë bëhet fjalë për një rekord, shkruan albinfo.ch. Një fatlum nga rajoni i Zvicrës Veriperëndimore fitoi shumën e pabesueshme prej 183.897.039 frangash të martën. Ky kishte blerë një tiketë vetëm 24.50 franga. Siç njoftoi Swislos, personi ka qëlluar pesë numrat e saktë: 7, 17, 29, 37, 45 dhe numrat plotësues 3 dhe 11. Kështu, fatlumi thyen rekordin e mëparshëm zviceran prej 157 milionë frangash, që ishte regjistruar më 19 dhjetor 2017. Lojtari me fat vjen nga rajoni i Zvicrës veriperëndimore, d.m.th. ose nga kantoni Aargau, Basel-Land, Basel-Stadt ose Solothurn, siç njoftoi Swislos. Detajet nuk njoftuan kompaninë e lotarisë. Fituesi ka gjashtë muaj për t'i marrë paratë.

Lojtari me fat nuk mund ta mbajë gjithë shumën e fituar. Operatori i lotarisë parashikoi 35 për qind të kësaj shume si tatim në burim për qeverinë federale, në këtë rast mbi 64 milionë franga zvicerane.



Fituesi mund të kërkojë shumën më vonë në kthimin e taksave. Megjithatë, varësisht nga vendi i banimit, bëhet fjalë për taksat të zakonshme mbi të ardhurat që kapin shuma milionëshe. "Euro Millions" ka përfshirë që nga tetori i vitit 2004 edhe Zvi-

crën. Përveç Zvicrës, "Euro Millions" gjithashtu mund të luhet në Portugali, Spanjë, Francë, Luksemburg, Belgjikë, Britani të Madhe, Irlandë dhe Austri. Që atëherë, 52 nga një total prej 973 milionë fitimesh kanë shkruar për fituesit nga Zvicra.

1143 - Mbreti Alfonso VII i Lionit një Mbretërinë e Portugalisë.

1665 - Themelohet Universiteti i Kielit.

1789 - Revolucion i francez: Gratë e Parisit marshojnë në Versajë për të konfrontuar Luigjin e XVI në lidhje me refuzimin e tij për të shpallur dekretin për heqje të feudalizmit, për të kërkuar bukë dhe Mbreti së bashku me gjykatën e tij të shpërngulen në Paris.

1796 - Spanja i shpall luftë Anglisë.

1908 - Bullgaria shpall pavarësinë nga Turqia, Ferdinandi I shpallet Car.

1911 - Trupat italian okupojnë Tripolin.

1942 - 5,000 hebrenj masakrohen në Dubno, Rusi.

1945 - Formohet ushtria e indoneziane.

1957 - Disidenti jugosllav Millovan Gjillas arrestohet me 7 vjet burg.

1978 - Isaac Bashevis Singer fiton Çmimin Nobel për letërsi.



MISHI I PËRPUNUAR SHKAKTAR I KANCERIT TË GJIRIT

Ushqimet si proshuta apo salsicet nëse i hani rregullisht mund të jenë shkakuar të kancerit në gjirë. Këtë e thotë një hulumtim i bërë së fundi nga Organizata Botërore e Ushqimit ku gratë që hëngrën çdo ditë këso ushqimesh patën mundësinë për 9% të preken më shumë me kancer se sa ato që hëngrën disa herë. Pra ju duhet të shkurtoni konsumimin e këtij lloji të mishit e jo të eliminoni.

POLICIA NË VENDIN E KRIMIT

Një grua vret burrin dhe policia mbërrin në vendin e krimit. Polici merr shëf në radio për ti raportuar ngjarjen:

- Shef, gruaja e ka goditur trupin rreth 6 herë me thikë dhe rreth 12 herë me pistoletë dhe e ka hedhur nga kati i 7.

- Po a arritët të zbuloni se cili ka qenë shkak i kësaj vrasje?

- Po shef, gruaja i kishte thënë burrit që të mos kaloj mbi dyscheme deri sa ajo të thahet!

- Po mirë, po gruan e keni kapur?

- Jo shef akoma, po presim të thahet dyschemeja!



Kam vendosur të jem i lumtur, sepse i bën mirë shëndetit tim.

(Voltaire)